

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7637 E premte 31 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës
Në Europë kanë filluar veprimtaritë me rastin e 100-Vjetorit të mbarimit të Luftës së I Botërore që do të vazhdojnë deri më 11 Nëntor; ditën e këtij jubileu ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE
Po më tej, çdo të ndodhë?


Opinion i Ditës
Shirat e paralajmëruar të verës Sqëlluan një profeci e perealizuar. 'Gusht dhe gunë' thoshin të parët, por i nxehti afrikan ka marrë tashmë të tatëpjetën, pa ...
Vijon në faqen 21

Nga ILIR KALEMAJ
Mbreti lakuriq




Procedura për certifikatën e pronësisë
ALUIZNI: Emrat, 650 familjet që kanë gati lejen e legalizimit

Lista me pronarët e rinj në qarqet Fier dhe Berat. Udhëzimi, si merret tapia e tokës
ORNELA MANJANI
ALUIZNI publikon listën me 650 pronarët që kanë gati lejen e legalizimit në qarqet Fier e Berat. Përfutuesit duhet të tërheqin lejen e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen ...
Në faqet 8-9

BRESHERI KALLASHI NE BANESEN E GAZETARES SE "NEWS 24" KLODIANA LALA ATENTATI, PLUMBA NDAJ SHTEPISE SE GAZETARES

Ambasada e SHBA: Autorët para drejtësisë. Meta-Rama, mesazhe solidariteti. Policia gjen 10 gëzhoja. Basha: Lala zbuloi lidhjet e deputetit të PS me Shullazin



(Në foto) Shenjat e plumbave në banesën e prindërve të gazetares Klodiana Lala. Klodiana Lala
Në faqet 2-5

LEVIZJA E LIRE
Prishtina në festë, Komiteti i PE voton heqjen e vizave me Kosovën
Në faqen 12

NGA DASHNOR KALOÇI
Spiro Koleka: Kush e quajti Mehmetin armik në aktivin e Pogradecit
Në faqet 10-11

KRYETARJA E LSI
Kryemadhi: Opozita, kandidatë të përbashkët në zgjedhjet lokale
Në faqen 6

KULTURE
Izet Duraku: Fatos Arapi, poeti ynë që e lamë në harresë
Në faqen 19

PROMOVON ALPET

Meta ngjitet në majën më të lartë, të Jezercës: E bukura e qiellit
Në faqen 17

Arsimi i lartë, rektori Ethem Ruka: Shifra premtuese, fluksin e presim me entuziazëm
"Luarasi", regjistrimet 7-fish më shumë se vjet
Mateo Spaho: 509 aplikime vetëm te Ekonomiku. Dorina Gjipali: Tejkallim pritshmërie

Nga VOLTIZA DURO
Ditën e djeshme Kolegji Universitar "Luarasi" ka nisur dje procesin e regjistrimeve të studentëve për vitin e ri akademik 2018-2019. Vetëm në ditën e parë numri i maturantëve që janë bërë pjesë e këtij



universiteti ka qenë 7 herë më i lartë, krahasuar me vitin e kaluar. Rektori i "Luarasit", prof. dr Ethem Ruka shprehet se fluksi i studentëve tregon qartë dëshirën dhe interesin e të rinjve për të vijuar studimet në këtë ...
Në faqen 7

ATENTATI MEDIA E LIRE

Gazetarët të kërcënuar me jetë, rastet më të rënda të ndodhura në dy vitet e fundit

Klodiana Lala: Jemi të tronditur, sulmi për shkak të detyrës

Gazetarët në protestë: Janë plumba mbi ne

Ina Allkanjari

Dyshoj se sulmi vjen si rezultat i punës sime si gazetare. Këtë profesion e kam ushtruar me ndershmëri e profesionalizëm ndër vite, e do vazhdoj këtë detyrë me të njëjtin përkushtim, pavarësisht gjithçkaje". Kështu është shprehur ditën e djeshme gazetarja Klodiana Lala, pas sulmit në banesën e prindërve të saj. Në një postim në Facebook, Lala shkruan se ajo e familja e saj janë të tronditur, ndërsa thotë se nuk kanë asnjë konflikt personal me askënd. Më tej gazetarja falënderon ministrin e Brendshëm dhe Policinë e Shtetit që u angazhuan maksimalisht për zbardhjen e ngjarjes. Ajo shpreh mirënjohjen për këdo që i është gjendur pranë në këto momente të vështira. "Te dashur miq! Po ju flas në emrin tim dhe të familjarëve të mi. Jemi mirë, asnjëri prej nesh nuk është lënduar Megjithatë, jemi të tronditur nga ngjarja. Duke i lënë institucionet të bëjnë punën e tyre, ju siguroj se unë dhe familjarët e mi, nuk kemi asnjë konflikt personal. Dysshoj se sulmi vjen si rezultat i punës sime si gazetare. Këtë profesion e kam ushtruar me ndershmëri e profesionalizëm ndër vite, e do vazhdoj këtë detyrë me të njëjtin përkushtim, pavarësisht gjithçkaje. Falënderim Ministrisë të Brendshëm dhe Policisë së Shtetit që u angazhuan maksimalisht për zbardhjen e ngjarjes. Ju jam mirënjohës secilit prej jush që po më gjendet pranë në këto momente", shkruan gazetarja Klodiana Lala në postimin e saj. Gjatë ditës së djeshme gazetare, qytetarë e aktivistë të shoqërisë civile janë mbledhur në shenjë proteste para kryeministrisë duke kërkuar drejtësi dhe liri në profesionin e tyre. Gazetarët shprehën solidaritetin e tyre dhe thonë se sulmi ndaj Klodianas Lales është sulm ndaj gjithë gazetarëve në Shqipëri.

PRECEDENTËT
Ky nuk është rasti i vetëm që gazetarja Klodiana Lala kërcënohet. Vlen të kujtojmë



Gazetarja Klodiana Lala

në kohën kur Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm përballje në Këshilli i Rregullorëve në Kuvend për heqjen apo jo të imunitetit, mbështetësit e tij sulmuan gazetaren. Nga "gazetare e qelbur" e deri te "surratja", ishin një lumë fytyeresh që ranë mbi gazetaren live gjatë deklaratës për medi-

at të Tahirit. Vetëm një muaj më parë një grup xhirimi i Top Channel, i cili po filmonte aktivitetin e hidrocentraleve në Valbonë, u sulmua nga disa persona të cilët rezultuan se ishin punonjës të një kompanie "security", të kontraktuar nga firma "Gener 2". Në mars të 2017, dy persona

BE
"Dënojmë sulmin kundër gazetares investigative Klodiana Lala dhe përsërisim mbështetjen tonë më të fortë për gazetarët në vijën e frontit të raportimit mbi krimin e organizuar në Shqipëri. Ne ftojme autoritetet që të hetojnë plotësisht dhe menjëherë ngjarjen", thuhet në reagimin e delegacionit të BE.

dhunuan barbarisht gazetarin Elvi Fundo, teksa ky i fundit po shkonte për tek puna e tij. Këto janë rastet më të rënda të ndodhura në dy vitet e fundit.



Banesa ku ndodhi sulmi me armë



SHBA

REAGIMI

"Ambasada e Shteteve të Bashkuara dënon me forcë sulmin ndaj gazetares Klodiana Lala dhe familjes së saj. Ne nxisim autoritetet shqiptare të kryejnë një hetim tërësor dhe transparent për të nxjerrë autorët përpara drejtësisë. Si gazetare, Klodiana ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbulimin e reformës në drejtësi, çështjeve të gjyqësorit dhe veprimtarisë kriminale.", thuhet në deklaratën e ambasadës amerikane në Tiranë.

Gjykata lë në burg 33-vjeçarin

Vrasja e 54-vjeçarit në Shkodër, Alfred Pllumbaj: E bëra për vetmbrojtje

Gjykata e Shkodrës ka dhënë ditën e djeshme masën e sigurisë për Alfred Pllumbaj, i dyshuar për vrasjen e Prendush Fushës, ngjarje e ndodhur më 27 gusht në Shkodër. 55-vjeçari mbeti i vrarë me thikë gjatë një përleshjeje me 33-vjeçarin Pllumbaj. E gjithë ngjarja nisi pas një vjedhjeje të ndodhur në banesën e viktimës. Prendush Fushës i janë vjedhur një shumë prej 700 mijë lekësh të vjetër në shtëpinë e tij, ndërsa ka dyshuar se autor i vjedhjes është Alfred Pllumbaj bashkë me disa të tjerë dhe për këtë ka bërë një kallëzim edhe në po-

licinë e Shkodrës. Por autori i dyshuar është lënë i lirë për mungesë provash. Banesa dhe një dyqan biçikletash ku viktimja punonte janë ngjitur me shtëpinë e autorit. Në këtë mënyrë autori të vetmen mundësi për të shkuar drejt qendrës së qytetit e ka duke u përshkuar në afërsi të banesës së 55-vjeçarit dhe dyqanit të tij që është thuasë ngjitur. Alfred Pllumbaj tha para gjykatës se pasi ka dalë nga banesa e tij është thirrur nga shtetasi Prendush Fusha duke e qenë se e ka parë duke kaluar. 33-vjeçari ka hyrë tek dyqani i riparimit të biçikletave dhe aty sipas tij viktimja i ka thënë se "a po më kthen ato

700 mijë lekë që më ke vjedhur". Autori e ka mohuar një gjë të tillë duke thënë se nuk asnjë lidhje me vjedhjen e parave. 33-vjeçari deklaroi para trupës gjyqësore se autori i dyshuar është munduar që ta bind se nuk e bërë ai vjedhjen, por debati në dyqanin e riparimit të biçikletave ka vijuar derisa në një moment sipas 33-vjeçarit, Prendush Fusha ka marrë një thikë që e kishte në dyqanin e tij duke tentuar që ta godasë për t'u vetëmbrojtur. Ai tregoi se është përleshur me viktimën dhe në përleshje e sipër trup më trup thika i ka hyrë poshtë zëmërës 55-vjeçarit, i cili humbi jetën.



Autori ka pranuar atë që ka ndodhur, por ka thënë përpara gjykatës se nuk ka shkuar ai vetë tek dyqani, por është thirrur nga Prendush Fusha dhe se nuk ka dashur që ta vrasë apo ta godasë, por thjeshtë është vetëmbrojtur dhe se 55-vjeçari ka marrë goditjen me thikë poshtë zëmërës

gjatë përleshjes duke mos pasur qëllim që ta vrasë deklaroi shtetasi Alfred Pllumbaj përpara gjykatës. Pllumbaj u shpreh se nuk ka pasur as thikë dhe asgjë tjetër me vetë dhe se thikën e ka marrë viktimja në dyqanin e tij duke tentuar që ta godasë 33-vjeçarin. **Se.NI.**



Në shtëpi ndodheshin edhe dy fëmijët e Klodiana Lalës. Marku: Të gjenden autorët

Goditet fjala e lirë, breshëri plumbash në banesën e gazetares

Policia: Gjenden 10 gëzhoja kallashnikovi



Unioni i Gazetarëve Shqiptarë: Policia të hetojë ngjarjen

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka reaguar pas sulmit me armë të kryer mëngjesin e djeshëm në banesën prindërive të gazetares së kronikës në News24, Klodiana Lala. Përmes një deklarate, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë denoncon me forcë sulmin e kryer dhe i bën thirrje Policisë së Shtetit që urgjent të hetojë ngjarjen dhe të dërgojë autorët para drejtësisë, pasi çdo vonesë do të ndikojë edhe më shumë në acarimin e klimës së lirisë së shprehjes në Shqipëri.

DEKLARATA E PLOTË

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë denoncon me forcë sulmin e kryer në banesën e reporterit të njohur Klodiana Lala në mëngjesin e ditës së sotme. Vetë gazetarja Klodiana Lala, i tha zyrës së shtypit të UGSH-së se sulmi është një tentativë e pastër për të frikësuar atë dhe ka ndodhur për shkak të detyrës së saj si reporter. UGSH i bën thirrje Policisë së Shtetit që urgjent të hetojë ngjarjen dhe të dërgojë autorët para drejtësisë, pasi çdo vonesë do të ndikojë edhe më shumë në acarimin e klimës së lirisë së shprehjes në Shqipëri. Policia nuk duhet të merret me detaje që çorodisin më shumë opinionin, por të gjejë autorin ose autorët e kësaj ngjarjeje shumë të rëndë. Kur sulmohet lajmësi, rrezikohet rëndë një nga të drejtat themelore kushtetuese. UGSH është në kontakt intensiv me organizmat ndërkombëtare në Shqipëri për të kërkuar një angazhim sa më aktiv në mbrojtje të gazetareve. Ne u bëjmë thirrje institucioneve shqiptare që nga Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe veçanërisht Ministria e Brendshme të reagojnë menjëherë duke dënuar ashpër sulmin dhe të merren në mbrojtje reporterët.

Ina Allkanjari
TIRANË

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri kallashnikovi mbi shtëpinë e prindërve të gazetares së 'News24', Klodiana Lala. Në momentin e sulmit në banesë ndodheshin edhe dy fëmijët. Fatmirësisht nuk ka të lënduar në njerëz ndërkohë policia e cila shkoi menjëherë në vendngjarje sqaron se është qëlluar në drejtim të pjesës së jashtme të banesës së babait të Lalës. Plumbat kanë prekur muret e banesës, si edhe kasën e derës së jashtme të saj, ndërsa në vendngjarje janë gjetur 10 gëzhoja kallashnikovi. Autorët e dyshuar janë pozicionuar pranë murit të jashtëm të banesës dhe kanë hapur zjarr. "Më datë 30.08.2018, rreth orëve të mëngjesit, në lagjen "Bruk", në rrugën "Shkëndija" është qëlluar me armë zjarri në drejtim të pjesës së jashtme të banesës së shtetasit A. L., rreth 64 vjeç.

Nuk ka dëme në njerëz. Po punohet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve", thuhet në njoftimin e policisë. Në banesën, të cilën e kanë sulmuar me armë, gazetarja Lala kalon një pjesë të madhe të kohës dhe të fëmijët e saj. Në momentin e ngjarjes brenda banesës kanë qenë 8 persona, prindërit, motra, vëllai, të afërm të familjes dhe 2 vajzat e gazetares Lala përkatësisht 2 dhe 5 vjeç. Vetë gazetarja dhe bashkëshorti i saj nuk ndod-



Përgjimet mes Çyrbjes dhe anëtarit të bandës së Shullazit, lajmi i Lalës që trazoi politikën

Ishte data 17 gusht kur gazetarja e News 24 do të publikonte dosjen e prokurorisë ku ishin të zbardhura përgjimet mes Jurgis Çyrbjes, ish-zyrtar i lartë i hipotekës në Durrës, aktualisht deputet i Partisë Socialiste dhe një anëtar i të bandës së Emiljano Shullazit. Pjesë nga teksti i lajmit të gazetares Klodiana Lala: "Referuar dosjes hetimore rezultojn se menjëherë sapo një oficer i policisë gjyqësore shkoi në zyrat e hipotekës në Durrës për të sekuestruar praktikën e regjistrimit të ish-hotel Vollgës, Çyrbja telefonon Gilmando Danin, i konsideruar si krahu i djathtë i Shullazit. Ligjëvënsi e informon atë, se prokuroria ishte vënë në lëvizje dhe shprehte shqetësim për këtë fakt. "E kemi keq punën. Lidhet me detyrën time", dëgjohej Çyrbja t'i thotë të pandehurit. Po atë ditë, prokurorët e ftuan Çyrbjan, të jepte shpjegime me cilësinë e personit që kishte dënuar për rrethanat e hetimit. Pasi mbaron rrëfimin e tij, pa kapërcyer rrethimin e godinës së xhamit, ligjëvënsi telefonon sërish Gilmando Danin dhe i kërkon të takohet. Nga ai moment deputeti dhe i dyshuari nuk rezultoi të kenë folur më në telefon".

heshin në banesë. Mësohet se afër banesës në çastin kur ndodhi sulmi ishte duke u zhvilluar një dasmë dhe në momentet e para familjarët e gazetares menduan se ishin fishekzjarre. Krismat kanë terrorizuar familjarët, të cilët tentuan të dalin jashtë banesës ende pa u ndalur

sulmi, pa kuptuar se shtëpia e tyre ishte shënjestra e agresorëve. Por kur plumbat kanë depërtuar xhamat e banesës ata janë shokuar. Fatmirësisht nga kjo ngjarje nuk pati të lënduar. Sapo ka mësuar mbi sulmin nga prindërit e saj, gazetarja Lala ka njoftuar policinë, e cila ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka kryer veprimet hetimore. Për zbardhjen e ngjarjes është interesuar personalisht edhe ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë si dhe krerët më të lartë të uniformave blu. Nuk dihen ende rrethanat e kësaj ngjarje, ndërsa dyshohet se sulmi ka lidhje me detyrën e saj si gazetare.

ARTA MARKU
Pas sulmit ka reaguar edhe Prokurorja e Përgjithshme, Arta Marku. Marku shpreh shqetësimin për sulmin dhe thotë se mbështet hetimin transparent për të venë përpara drejtësisë autorët.

"Prokurorja e Përgjithshme Arta Marku shpreh shqetësimin e thellë për sulmin ndaj familjarëve të gazetares Klodiana Lala mëngjesin e datës 30 gusht. Kryeprokurorja nxit dhe mbështet plotësisht hetimin transparent për të venë përpara drejtësisë autorët e sulmit. Prokuroria e Përgjithshme rithekon angazhimin për të venë në dispozicion burime njerëzore dhe infrastrukturor për të garantuar punën e Prokurorisë së Tiranës. Marku gmon punën e gazetares Lala dhe trupës së gazetareve që përballen me vështirësi dhe rrezeje në kërkim, zbardhje dhe raportim të së vërtetës", thuhet në reagimin e kryeprokurores.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbarrimore L.D.C
-Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Leke.
Data e shpalljes 01.08.2018
Data e zhvillimit 05.09.2018 deri ne oren 16.00
Ankandë zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

SULMI NDAJ GAZETARES REAGIMET

Kreu i PD mesazh Ramës: Do mbash t'i përgjegjësi po iu prek një fije floku gazetares

Basha: Sulmi mafioz, Lala zbuloi lidhjet e deputetit të PS me Shullazin

"Plumbat në dhomën ku flinin vajzat"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha dënoi dje sulmin ndaj gazetares së "News24", Klodiana Lala ndërsa paralajmëroi kryeministrin Edi Rama se do të mbajë përgjegjësi nëse gazetares i preket një fije floku. Në një dalje të posaçme për mediat z.Basha deklaroi që ky është një mesazh i qartë se sundon krimi në vend. Kryetari i PD-së i bëri thirrje kryeministrin Rama të gjejë "mafiozët" që përdorin armët ndaj gazetares Klodiana Lala. Ai zbuloi se plumbat kanë goditur dhomën ku flenë vajzat e gazetares që mbulon lajmet në fushën e drejtësisë dhe shkak ka qenë publikimi i lidhjeve të ngushta të deputetit të Edi Ramës, Jurgis Çyrbja me bandën e Emiljano Shullazit. "Mesazhi mafioz për gazetaren është i qartë: se kush del nga rreshiti, kush shqetëson qeverinë, kush nuk i bindet sundimit të kimit, e ka fundin e shpejtë. Sulmi me armë ndaj gazetares Klodiana Lala, e cila së fundmi nxori në dritë lidhjet e ngushta të deputetit të Edi Ramës, Jurgis Çyrbja me bandën e Emiljano Shullazit, janë tregues se krimi ndjehet i paprekshëm! Dhe kjo është e vërteta e hidhur! Prej 5 vjetësh krimi po triumfon, sepse ai bashkëqeverisë me Edi Ramën! deklaroi z.Basha. Po ashtu Basha tha se është në krah të gazetares dhe do jetë gjithmonë në mbështetje të saj. Sipas tij, mesazhi ishte i qartë: Kush shqetëson qeverinë e ka fundin e shpejtë. Ai shprehu mbështetjen dhe të partisë që drejton për gazetaren dhe familjen e saj. "Sot u realizua dhe ajo pjesë e vendeve që sundohen nga krimi. Një gazetare është sulmuar me armë. Familja e gazetares Klodiana Lala, është tronditur nga plumbat. Mesazhi është i qartë, kush shqetëson qeverinë e ka fundin e shpejtë. Shpreh mbështetjen time dhe PD



Lulzim Basha kreu i PD-së

"Gazetarja po hetonte trafiket"

Sulmi ndaj Lalës, Berisha-Ramës: Vrimë miu nuk do gjesh

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se gazetari Klodiana Lala po hetonte kokainën, krimin dhe trafiket kriminale të niveleve më të larta të familjeve qeveritare mafioze ndër të cilat edhe vetë të Noriegës. Ndaj Berisha kërcënoi kryeministrin Edi Rama se "vrime miu nuk do gjejë dhe se do ketë fatin e diktatorit panamez". "Ky akt i porositur dhe organizuar nga familjet e mëdha mafioze të narkoqeverisë së Noriegës, përbën një përshtetëzim të ri tepër të rrezikshëm të diktatit të mafies qeveritare, përpjekjeve mafioze e kriminale të saj për t'i mbyllur gojën një gazetareje investigative, e cila po investigonte me guxim dhe vendosmëri mbi kokainën, krimin dhe trafiket kriminale të niveleve më të larta të familjeve qeveritare mafioze ndër të cilat edhe vetë të Noriegës. Duke dënuar me ashpërsinë më të madhe këtë sulm të hapur, primitiv, mafioze terrorist ndaj gazetares që po heton me vendosmëri lidhjet mafioze të organizatave kriminale me nivelet më të larta të narkoqeverisë shqiptare, le të paralajmërojmë të dashur miq Noriegën se vrimë miu nuk do gjesh të futesh dhe se fatin e diktatorit panamez do të pëshosh, por jo nga marinsat e SHBA, por nga qytetarët dhe aleanca antikrim e Shqipërisë në rast se vazhdon me këto akte hakmarrje primitive ndaj Klodiana Lalës, familjes së saj apo çdo gazetari në këtë vend!", shprehet z.Berisha.

AKUZA

"Sulmi me armë ndaj gazetares Klodiana Lala, e cila së fundmi nxori në dritë lidhjet e ngushta të deputetit të Edi Ramës, Jurgis Çyrbja me bandën e Emiljano Shullazit, janë tregues se krimi ndjehet i paprekshëm!," - deklaroi kreu i PD-së.

për Klodiana Lalën, familjen e saj, për çdo gazetar të pablerë ndaj kësaj qeverie që bashkëpunon me krimin. Kemi vetëm një rrugë për të fituar betejën, duhet të gëndrojmë, duhet të fitojmë. Ne ia kemi dalë të largojmë nga parlamentet disa dhjetëra kriminelë me të cilët Rama erdhi në pushtet, por fitorja s'është ende në anën e shoqërisë", - theksoi z.Basha. Kreu i PD-së i kërkoi Edi Ramën: "të lërë lotët e krokodilit dhe të gjejë autorët e sulmit mafioz me armë kundër gazetares Klodiana Lala! Le të thërrasë banditët e vet brenda dhe jashtë burgut, le të flasë me horrat e vet brenda dhe jashtë parlamentit dhe të gjejë mafiozët që, nën mbrojtjen e qeverisë së tij, guxojnë të përdorin armë kundër gazetareve që zbulojnë lidhjet e krimin me qeverinë e Edi Ramës". Basha paralajmëroi kryeministrin: "Sot, kam edhe një mesazh për Edi Ramën: do të mbahesh ti përgjegjës i vetëm, nëse gazetares Klodiana Lala, familjes së saj, çdo gazetar i që nuk ha bukën tënde apo çdo opozitari me qeverinë tënde i preket goftë edhe një fije floku nga horrat dhe krimi që ke nën urdhra! Mesazhi im për çdo qytetar është se sa kohë kryeministri i vendit është i lidhur me krimin, Shqipëria do jetë në mëshirën e bandave. Me të mirat dhe të këqijat tona, duhet të qëndrojmë të bashkuar dhe të çlirohemi nga krimi që qeveris vendin".



Kryemadhi: Breshëria e armëve ndaj Klodit, dhe gjithë shqiptarëve

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, dënoi ashpër sulmin me armë në shtëpinë e prindërve të gazetares Klodiana Lala. Gjatë takimit me strukturat e LSI-së së Tiranës, Kryemadhi, tha se breshëria e kallashnikovit sot nuk ishte vetëm ndaj Klodiana Lalës, por ndaj të gjithë shqiptarëve. Ajo u ka bërë apel gazetareve dhe qytetarëve shqiptarë që të bashkohen, sepse vetëm të bashkuar mund të mundin këtë grup kriminelësh të drejtuar nga Edi Rama. "Sot me Klodiana Lalën janë të gjithë shqiptarët. Sot ky akt tregoi se banda dhe krimi janë ulur këmbëkryq. Sulmi ndaj Klodiana Lalës nuk është vetëm tek ajo, por tek të gjithë ne. Breshëria ndaj Klodiana Lalës, ishte për të gjithë shqiptarët. Përballë këtij realiteti kriminal është bashkimi frontal. I them Klodit mos tërhiqet. Është e vështirë të përballësh e vetme, por duke qenë të gjithë bashkë, do të jemi më të fortë përballë një numri të vogël kriminelësh. Jemi në mbështetje të gazetareve, të cilët përballen në këtë realitet kriminal të drejtuar nga kryeministri i drogë,-tha Kryemadhi.



Nishani: Prova nëse do ulim kokën, apo do luftojmë krimin

Ish-presidenti i Republikës, Bujar Nishani reagoi dje pas sulmit me armë ndaj banesës së prindërve të gazetares së "News24", Klodiana Lala. Nishani shprehet se sulmi ndaj gazetares është sulm ndaj gjithë shoqërisë tonë. "Kjo është prova nëse do të ulim kokën ndaj çizmes së kimit dhe do të heshtim, apo do të drejtë", -thotë ndër të tjera Nishani. "Të dashur miq të solidarizohemi të gjithë dhe hapur me gazetaren Klodiana Lala pas sulmit dhe kërcënimit që krimi bëri jo ndaj vetë një gazetareje, nëne dhe qytetare kurajoze, por ndaj të gjithë shoqërisë tonë. Kjo është prova nëse do të ulim kokën ndaj çizmes së kimit dhe do të heshtim, apo do të drejtë ligjin, rendin, të drejtën", -thotë ndër të tjera Nishani. "Të dashur miq të solidarizohemi të gjithë dhe hapur me gazetaren Klodiana Lala pas sulmit dhe kërcënimit që krimi bëri jo ndaj vetë një gazetareje, nëne dhe qytetare kurajoze, por ndaj të gjithë shoqërisë tonë. Kjo është prova nëse do të ulim kokën ndaj çizmes së kimit dhe do të heshtim, apo do të drejtë ligjin, rendin, të drejtën, dënimin e të keqes, që është një rrezik për të gjithë ne pa përjashtim, nëse e tolerojmë. Solidaritet me Klodiana, nënë, sfidë kriminelëve! Të gjithë bashkë!", -shprehet z.Nishani.



Sulmi ndaj gazetares, Rama: E patolerueshme barbaria, pres me padurim ndëshkimin e keqbërësve

Ilir Meta telefonon Lalën: Mbështetje, vazhdo misionin tënd

“Organet e sundimit të ligjit të hetojnë”

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta dënon me ashpërsi sulmin me armë të kryer ndaj banesës së mirënjohur investigative, Klodiana Lala. Edhe përmes një bisede telefonike ku shprehu solidaritet të plotë me gazetaren Lala, dy vajzat e saj të mitura dhe prindërit e saj, Presidenti Meta e inkurajoi të vijojë misionin e saj, pa u trembur dhe shantazhuar nga askush. “Po kështu inkurajoj organet e sundimit të ligjit të hetojnë në mënyrë të plotë dhe shteruese, këtë ngjarje të rëndë, e të venë para ligjit këdo që qëndron pas saj. Liria e medias është kusht i pazëvendësueshëm për garantimin e të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike”, - nënvizoi Presidenti Meta. Mësohet se kreu i shtetit, ka komunikuar edhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë në lidhje me këtë ngjarje. Pas sulmit mbi banesën e babait të gazetares Klodiana Lala ka ardhur dhe një reagim nga kryeministri Edi Rama. Rama shkruan në një postim në “Twitter” se është e patolerueshme barbaria ndaj gazetares Klodiana Lala. Po ashtu pret me padurim ndëshkimin e keqbërësve. “E patolerueshme barbaria mbi shtëpinë e gazetares Klodiana Lala! Ngjarja duhet zbardhur sa më parë dhe strukturat e shtetit janë të angazhuara maksimalisht. Mbështes e inkurajoj Klodianën në këtë moment kritik dhe pres me padurim ndëshkimin e keqbërësve”, shprehet z.Rama. Banesa e prindërve të gazetares së kronikës Klodiana Lala është bërë pre e një sulmi me armë mëngjesin e djeshëm. Sulmi ka ndodhur rreth orës 03:00 të mëngjesit, ndërsa fatmirësisht askush prej familjarëve nuk është lënduar. Në drejtim të banesës është derdhur një breshëri kallashnikov. Burimet saktësojnë se në momentet e sulmit familjarët e Lalës, prindërit, vëlai, por edhe fëmijët e gazetares ndodheshin në banesën e gazetares në lagjen “Bruk”, në rrugën “Shkëndija”. Policia në njoftimin e saj



Presidenti Ilir Meta me gazetaren Klodiana Lala

EDI PALOKA

“Palaço kryeministër, “jam i tronditur” thotë, ndërkohë që në vetë të parë i nxit kriminelët jo vetëm të kërcënojnë, por dhe të eliminojnë kundërshtarët e tij qofshin ata opozitarë në politikë, gazetarë apo qytetarë të thjeshtë...”, - shprehet z.Paloka.

FATMIR MEDIU

Sulmi kundër Kodiana Lalës dhe familjes së saj është një akt kriminal, i cili nuk synon që të godasë vetëm fjalën e lirë, por kërkon që shqiptarët, gazetarët të heshtin përballë krimin të lidhur me pushtetin. Sot kemi një sulm të hapur kundër një gazetareje kurajoze, por çdo ditë ka raste pafund që kriminelët të lidhur me pushtetin sulmojnë qytetarë dhe biznese dhe bëjnë ligjin në qytetet kryesore të vendit”, -tha kreu i PR-së.



Deputetet e PS: E pafalshme dhuna ndaj familjes së gazetares

Deputetet femra të PS-së reagojnë në lidhje me sulmin ndaj banesës së prindërve të Klodianës. Sipas PS, dhuna është e papranueshme dhe nuk do të heshtet ndaj akteve kaq të rënda. “Ne, grupi i grave deputete të Partisë Socialiste, duam të shprehim shqetësimin tonë për kërcënimin e jetës së një gazetareje. Dënojmë me forcë sulmin ndaj gazetares Klodiana Lala dhe familjarëve të saj. Është e patolerueshme dhe e pafalshme që jo vetëm sulmohet një gazetare, por dhuna drejtohet edhe karshi familjarëve. Sulmohet një grua, e cila nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka ushtruar me profesionalizëm e ndershmëri misionin e gazetares. Sulmohet një nënë. Sulmohet liria e fjalës dhe e shprehjes. Ne, deputetet e PS-së nuk e pranojmë dhunën dhe nuk heshtim ndaj akteve të tilla kaq të rënda. Ne, deputetet e PS kemi bindjen që krimi nuk mund të mbulojë të vërtetën, nuk mund të frikësojë, kërcënojë apo lëndojë gazetarët dhe për më tepër, një gazetare grua që raporton për të vërtetën. Dhuna nuk mund të ndalojë guximin e një gruaje të bëjë me profesionalizëm punën e saj. Si politikane dhe qytetare të denja të këtij vendi, kërkojmë me forcë të zbardhet e vërteta dhe autorët e dhunës të vihen përballë drejtësisë. Kërkojmë po ashtu të sigurojmë, që për aq sa na takon do të bëjmë maksimumin për të nxitur organet përkatëse në sqarimin e kësaj ngjarjeje dhe për vënien para përgjegjësisë të autorëve të saj. Askush, për më tepër një grua, një nënë, një profesioniste, nuk duhet të ndihet e kërcënuar nga dora që kërkon t’i byllë rrugën lirisë së shprehjes! Ajo kohë, fatmirësisht, ka mbaruar një herë e përgjithmonë!”, thuhet në deklaratën e deputeteve të PS-së.

DHURATA ÇUPI

“Si nënë, si grua, si drejtuese e Aleancës së Grave Deputete dua të inkurajoj Klodianën për të përballuar këtë ngjarje në këtë ditë të vështirë për të dhe familjen e saj. Jam e bindur që ajo me profesionalizmin e palëkundur do të vijojë misionin e saj për informimin e publikut, por, po ashtu u kërkojmë organeve kompetente të zbardhin sa më parë këtë ngjarje të rëndë”, -tha deputetja e PD-së.



“Të këputen lidhjet e krimin me politikën”

Mustafaj: Krimi ndihet i lirë, kryeministri nuk mbron median



Ish-ministri, Besnik Mustafaj ka komentuar sulmin me armë ndaj banesës së prindërve të gazetares së News24, Klodiana Lala dhe u shpreh se kur mafia arrin të godasë mbi gazetaret tregon se ajo ndihet e lirë të veprojë dhe se autorët kanë lënë një mesazh se nëse gazetaret flasin, ata mund të godasin aty ku dhemb më shumë. “Kur mafia arrin të godasë mbi gazetaret tregon se ajo ndihet e lirë të veprojë. Mbi shtypin ka goditur mafia italiane dhe Eskobari, ndërsa të tjerët nuk kanë sulmuar asnjëherë gazetaret, pavarësisht se ata janë të ndëshkuar në vendet e luftës. Sulmi është

të një tregues se krimi është i lirë dhe ky guxim që merr krimi është një mesazh mafioz. Ata nuk guxuan të bëjnë viktima, por kanë treguar se do godasin aty ku dhemb më shumë. Autorët kanë qenë në dijeni se gazetarja nuk kanë qenë në banesë. Ata kanë dashur të thonë se nëse ju hapni gojën, ne do go-

dasim më shumë”, -tha Mustafaj. Ish-ministri tha, gjithashtu, se kryeministri nuk ka bërë asgjë për të mbrojtur median, por e quan “kazan”. Sipas Besnik Mustafaj, duhet të shkëputen lidhjet e politikës me krimin. “Nëse kryeministri thotë në mënyrë të përsëritur ‘kazan, kazan’ tregon se ai nuk do bëjë asgjë për të mbrojtur shtypin. Ministri Xhafaj duhet të dilte në konferencë për këtë çështje. Duhet të këputen lidhjet me politikën dhe politika përmes institucioneve duhet të godasë krimin. Ky sulm nuk është për gazetaret e kulturës, por një mesazh për gazetaret e terrenit dhe për drejtuesit e medias”, -tha Mustafaj.

zyrtar thotë se po heton për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Për ngjarjen reagoi

edhe Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, i cili dënon aktin e rëndë. Vetë Lala e kontaktuar

nga UGSH-ja, ka deklaruar se sulmi ka ndodhur për shkak të detyrës së saj si gazetare.

STRASBURGU PERPLASJA

Valentina Madani

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku akuzoi dje qeverinë për veprime të njëpasnjëshme në dëm të pronarëve. Në daljen mediatike, deputetja e PD akuzoi qeverinë se po shpronëson për herë të dytë pronarët, sipas saj, për të pasuruar një grup personash nën termin "pronarë të rinj". Këtu Tabaku përmendi miratimin e dy VKM-ve, që ajo tha se, i kanë dhënë autoritetin qeverisë që të mos ia kthejë pronën të zotit, por t'ia japë një investitor. Tabaku njoftoi për një letër të dërguar nga PD Gjykatës së Strasburgut për këtë shqetësim. Partia Demokratike, me anë të deputetes Jorida Tabaku njoftoi se i dërgoi një letër Gjykatës së Strasburgut në lidhje me pronat. Sipas Tabakut, PD i është drejtuar Strasburgut, pasi qeveria "Rama" po shpronëson për herë të dytë pronarët, për të pasuruar një grup personash nën termin "pronarë të rinj". "Vetë kryeministri Rama u investua personalisht për të miratuar ligjin "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", që bie në kundërshtim me Kushtetutën. Qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë masë për plotësimin e boshllëkut të krijuar nga shfuqizimi i disa dispozitave të këtij ligji nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për më shumë se 2 vite", shkruhet më tej në deklaratë. "Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konfirmoi dje zyrtarisht se qeveria shqiptare ka tentuar të ushtrojë presion dhe e ka konsideruar të papërshtatshme këtë ndërhyrje. Çdo gjë tjetër nga ana e qeverisë dhe prokurorisë është propagandë. Përfaqësues të qeverisë shqiptare, nën emrin dhe frymëzimin e drejtë për drejtë të kryeministrit Rama kanë kërkuar të ndikojnë në vendi-

Audio-përgjimi, PD informoi Brukselin për ligjin antikushtetues për pronat

Akuzat, Tabaku: Rama po grabit pronarët

Biba: U mbars mali e polli një mi

min e Gjykatës Europiane në lidhje me shqyrtimin e Ligjit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave". Një përpjekje e tillë jo vetëm që është e turpshme dhe fyese për një qeveri që këndon refrenin e reformës në drejtësi, por mbi të gjitha është edhe akti më domethënës i asaj çfarë përfaqëson Rama dhe qeveria e tij. Prandaj, jo rastësisht komunikimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe




Deputetja e PD-së Jorida Tabaku

emërimit e qeverisë shqiptare pranë kësaj gjykate, janë tërësisht partizane dhe politike. Qëllimi i këtyre emërimeve ka

qenë dhe mbetet krijimi i një linje informacioni të drejtpërdrejtë nga Gjykata tek Rama"-shprehet PD.

REAGIMI

Nënkryetari i KQZ Denar Biba ka reaguar sërish lidhur me audio-përgjimin mes tij dhe gjyqtarit shqiptar të Strasburgut Ledi Bianku, në të cilën PD pretendon se magistrati shantazhohet nga përfaqësuesi i mazhorancës për çështjen e pronave. Përmes një deklaratë për mediat nga selia e KQZ, Biba shprehet se "nese biseda do të publikohet e plotë, atëherë do të kuptohet se nuk jemi para një rasti shantazhi". "Fakti që Gjykata nuk reagoi atëherë, tregon se sa e parëndësishme ishte kjo. Nuk ka qenë bisedë e atillë që të shqetësonin Gjykatën e Strasburgut. Njerëz të caktuar u përdorën për teatër politik", deklaroi z. Biba. Ai shpjegoi më tej: "E vërteta do të zbulohet vetëm kur të publikohet audio e plotë. Siç tha vetë Gjykata e Strasburgut, unë kam takuar gjyqtarin dhe i kam kërkuar që të na asistonte në lidhje me një kërkesë të shtetit tonë për të mundësuar shtyrjen e afatit të ekzekutimit të një vendimi që në atë kohë, kur qeveria sapo ishte krijuar, do të vinte në pozitë shumë të vështirë financiare. Bianku e ka konsideruar bisedën me mua si qasje të papërshtatshme".



Lokalet, Kryemadhi: Opozita me kandidatët të përbashkët

Kryetarja e LSI Moni Ka Kryemadhi lajmëroi dje në një takim me strukturat e LSI-së në Tiranë, se opozita do të dalë me një kandidat të përbashkët në zgjedhjet lokale. "Opozita e bashkuar do të dalë bashkë në zgjedhjet e ardhshme. E rëndësishme është platforma jonë e përbashkët për uljen e taksave që çdo ditë e më shumë i marrin frymën shqiptareve, uljen e varfërisë dhe ofrimin në një shërbim me cilësi më të lartë". "Do evidentojmë çdo socialist të zhgënjyer nga rilindja dhe do bashkojmë forcat progresive të gjitha strukturat qofshin politike ose jo, në qendrat e votimit për të ngritur barrikatadë e protestës dhe revoltës ndaj uzurpimit të rilindjes që i ka bërë qytetit të Tiranës".

Rama në Gjirin e Lalzit: Ky, sezoni më i mirë turistik



shifrat janë shumë domethënëse. Këtë vit numri i aksidenteve tragjike është ulur. Nuk jemi aspak të vetëkënaqur derisa shifrat të jenë fare minimale, por ka progres. Nuk ka pasur mjete uji që qarkullonin mes notuesve. Ka

qenë viti më i disiplinuar nga pikëpamja e zhurrmave. Oraret e muzikës me zë të lartë janë kufizuar. Ka qenë viti më i mirë për shërbimet shëndetësore. I gjithë sistemi i pikave shëndetësore për sezonin ka funksionuar", tha Rama. Ai u ndal edhe te problemi i ndotjes duke theksuar se edhe në këtë drejtim është rritur ndërgjegjësimi. "Shqipëria është pis, sepse jemi të padrejtë me të. Nuk janë turistët e huaj që hedhin plehrat kudo ku u del nevoja, jemi ne. Sidoqoftë në këtë aspekt ka pasur progres"-deklaroi Rama.

KËRKESË PËR KUOTIM

Swisscontact është një fondacion i pavarur zviceran që promovon zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor. Objektivi i Swisscontact është krijimi i mundësive për të larguar nga varfëria njerëzit e vendeve në zhvillim përmes një zhvillimi ekonomik me bazë të gjerë. Përmes projekteve të ndryshme, Swisscontact lehtëson aksesin në programe të zhvillimit të aftësive, nxit sipërmarrjen konkurruese, krijon akses për shërbimet lokale financiare dhe promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve. Projekti Aftësi për Punë (Skills for Jobs) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, i zbatuar nga Swisscontact. Projekti është pjesë e Fushës së Zhvillimit Ekonomik të Strategjisë Zvicerane të Bashkëpunimit për Shqipërinë (2014-2017), me fokus të veçantë tek promovimi i mundësive për punësim dhe zhvillimin e aftësive. Swisscontact, në kuadrin e projektit Skills for Jobs, mandatar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, për mirëfunksionimin e Qendrave të Karrierës, zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Shkollës, aplikimit të mësimit të kombinuar dhe përmirësimit të infrastrukturës IT në shkollat partnere, kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerjen dhe instalimin e mobiljeve për shkollën "Pavarsia", "Tregtare" në Vlorë, "Kolin Gjokaj" Lezhë, "Hamdi Bushati" Shkodër, dhe "Gjergj Canco" Tiranë".

Për më shumë informacion në lidhje me thirrjen, ju lutem drejtohuni në faqen zyrtare të Swisscontact Albania, në linkun si më poshtë:

<http://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html>



Aftësi për Punë / Skills for Jobs



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BANKA E SHQIPËRISE

DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tenderi hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3.581.600 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një bankë tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutites: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkrahimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 02 Tetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Dorina Gjipali: Interes i lartë për Juridikun. Maturantët: Zgjedhja më e mirë për të ardhmen

Fillojnë regjistrimet në "Luarasi", numri i studentëve 7 herë më i lartë se 2017-a

Rektori Ethem Ruka: Fluks regjistrimesh

Voltiza Duro

Ditën e djeshme Kolegji Universitar "Luarasi" ka nisur dje procesin e regjistrimeve të studentëve për vitin e ri akademik 2018-2019. Vetëm në ditën e parë numri i maturantëve që janë bërë pjesë e këtij universiteti ka qenë 7 herë më i lartë, krahasuar me vitin e kaluar. Rektori i "Luarasi", prof. dr Ethem Ruka shprehet se fluksi i studentëve tregon qartë dëshirën dhe interesin e të rinjve për të vijuar studimet në këtë institucion elitar të arsimit të lartë. "Sot është dita e parë e regjistrimeve në universitete, dhe ne e presim me shumë entuziazëm si punonjës të arsimit të lartë, pasi me fundin e pushimeve, godina po merr gjallërinë e saj të zakonshme. Regjistrimet po ecin jashtëzakonisht shumë mirë e deri tani kemi një fluks maturantësh që po vijnë e po regjistrohen në të gjitha fakultetet që "Luarasi" ofron. Jemi shumë të gëzuar pasi shifrat me të vërtetë janë shumë premtuese", tregon Ruka. Më tej ky i fundit bën me dije se vetëm ditën e djeshme, numri i të regjistruarve në një nga programet Bachelor ka qenë 7 herë më i madh se në 2017-ën. "E gjithë kjo është fryt i reputacionit shumë pozitiv që ka Luarasi. Them me bindje se rritja e përzgjedhjes së këtij universiteti po kthehet në një realitet dhe numri i studentëve do të vijë duke u rritur", thotë më tej rektori i Kolegjit Universitar Luarasi.

FAKULTETI EKONOMIK

Edhe pse numri i kuotave të përcaktuara për programet e studimit në Fakultetin Ekonomik pranë "Luarasi"-t ka qenë 200, aplikimet e studentëve i kanë tejkaluar pritshmëritë. Sipas dekanit të këtij fakulteti, Mateo Spaho mbi 500 maturantë kanë aplikuar në një nga degët e Ekonomikut. "Që prej orës 8.30 të ditës së sotme (djeshme) ka filluar procesi i regjistrimit pranë Kolegjit Universitar "Luarasi" dhe natyrisht numri dhe fluksi i studentëve është mjaft i lartë. Vetëm për Fakultetin Ekonomik ka pasur 509 aplikime, në një kohë që "Luarasi" ka vetëm 200 kuota në dispozicion. Ne i ftojme studentët që kanë aplikuar në këtë fakultet që të regjistrohen sa më shpejt pasi kuotat realisht po përfundojnë", thotë Spaho. Më tej ky i fundit tregon se universiteti "Luarasi" është një institucion arsimor që ofron shanse të rëndësishme dhe jo vetëm në formimin akademik, por edhe në tregun e punës në të ardhmen. Sipas dekanit të Ekonomikut, në fakultet do të organizohen 6 aktivitetet të ndryshme ku do

të flitet mbi lidhjen me kompanitë e sigurimeve, kontabilitetit e ato të aktiviteteve prodhuese. Plani strategjik parashikon nënshkrimin e kontratave për të dërguar studentët e "Luarasi" pranë këtyre kompanive me synim kryerjen e intershipëve dhe gjetjen e mundësive të punësimit.

FAKULTETI DREJTËSISË

Edhe në Fakultetin e Drejtësisë të Kolegjit Universitar "Luarasi", kërkesat e maturantëve i kanë tejkaluar pritshmëritë. Përgjegjësjë e departamentit të së Drejtës Publike pranë Fakultetit Juridik në këtë institucion, Dr. Dorina Gjipali tregon se aplikimet kanë qenë disa herë më të larta se kuotat e vendosura në dispozicion. "Aplikimet në nivelin Bachelor janë përtej pritshmërive që ne kishim, madje kanë kaluar edhe numrin e kuotave të përcaktuara dhe për këtë fakt jemi shumë të kënaqur. Regjistrimet filluan sot (dje) pra në 30 gusht dhe përfundojnë në 12 shtator e gjatë kësaj periudhe kohore studentët kanë mundësi të bëjnë regjistrimet", thotë Gjipali. Më tej kjo e fundit i fton të gjithë maturantët që të shpejtojnë për t'u bërë pjesë e Luarasi, në mënyrë që të zënë një nga kuotat e vëna në dispozicion.

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE INOVACIONIT

Maturantët e këtij viti kanë shfaqur një interes të lartë edhe për fakultetin më të ri pranë universitetit "Luarasi", përkatësisht në programet e studimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Zv. Rektorja e këtij institucioni elitar, Anni Dasho Sharko tregon se ky fakultet vjen në funksion të kërkesave të tregut të punës. "Procesi i regjistrimit vetëm në këtë ditë të parë ka shkuar shumë mirë. Ne këtë vit vijmë me një risi, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, e madje pritshmëritë kanë qenë tejet të mira për këtë fakultet që sapo është hapur dhe kërkesat e gjimnazistëve kanë qenë shumë të mëdha. Numri i aplikimeve për këtë fakultet ka qenë rreth 300, përkundrajt kuotave që ne kemi vënë në dispozicion.



ETHEM RUKA FLUKS STUDENTËSH

"Sot është dita e parë e regjistrimeve në universitete, dhe ne e presim me shumë entuziazëm si punonjës të arsimit të lartë, pasi me fundin e pushimeve, godina po merr gjallërinë e saj të zakonshme. Regjistrimet po ecin jashtëzakonisht shumë mirë e deri tani kemi një fluks maturantësh që po vijnë e po regjistrohen në të gjitha fakultetet që "Luarasi" ofron. Jemi shumë të gëzuar pasi shifrat me të vërtetë janë shumë premtuese", tregon Ruka.




MATEO SPAHO NXITONI TË REGJISTROHENI

"Që prej orës 8:30 të ditës së sotme (djeshme) ka filluar procesi i regjistrimit pranë Kolegjit Universitar "Luarasi" dhe natyrisht numri dhe fluksi i studentëve është mjaft i lartë. Vetëm për Fakultetin Ekonomik ka pasur 509 aplikime, në një kohë që "Luarasi" ka vetëm 200 kuota në dispozicion. Ne i ftojme studentët që kanë aplikuar në këtë fakultet që të regjistrohen sa më shpejt pasi kuotat realisht po përfundojnë", thotë Spaho.



DORINA GJIPALI TEJKALIM PRITSHMËRISH

"Aplikimet në nivelin Bachelor janë përtej pritshmërive që ne kishim, madje kanë kaluar edhe numrin e kuotave të përcaktuara dhe për këtë fakt jemi shumë të kënaqur. Regjistrimet filluan sot (dje) pra në 30 gusht dhe përfundojnë në 12 shtator e gjatë kësaj periudhe kohore studentët kanë mundësi të bëjnë regjistrimet", thotë përgjegjësjë e departamentit të së Drejtës Publike pranë Fakultetit Juridik në këtë institucion, Dr. Dorina Gjipali.



NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYEQSORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META
ÇMIMI 4.118.696 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë **13.09.2018**
CEL. 0684026666 ; 0693262866.

SHPALLJE ANKANDI

Data 06.09.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
 Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajshme të debitorit Luan Zef Pali dhe dorëzueses Loreta Pjetri Pali:
 "Apartament" me sipërfaqe 88.9 m2, nr.i pasurisë 4/162+1-12, zona kadastrale 8631, vol. 6, faqe 20, adresa: Rruga "Gurra", pallati 138, shkalla 1, apartamenti 12, Lezhë.
 Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 2 419 984 (dy milionë e katërqind e nëntëmbdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.
 Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga Agjencia

ALUIZNI: 650 personat që kanë gati lejet e legalizimit

Lista me pronarët në qarqet Fier e Berat

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 650 pronarët që kanë gati lejet e legalizimit në qarqet Fier e Berat. Përfituesit duhet të tërheqin lejen e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. "Gazeta Shqiptare" sjell listën e plotë me personat që kanë të printuara lejet.

TAPIA
Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë proce-

dura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytë-



zohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas

vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka

shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në ras-

tin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përfecë pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti.

ELISABETA	FAIK	LAMAJ	PELIVAN	CAUSH	SHEQERI	FADIL	IBRAHIM	OSHAFI	ALUSH	ARSHIN	BRAMI
EDMIR	RUSTEM	LAMAJ	NOVRUS	PELIVAN	KANANI	VALENTINA	FEJZO	OSHAFI	VULLNET	ALUSH	BRAMI
ELTON	SHPETIM	TAFIL	GENTIAN	KUTIM	ÇAKO	QERIM	HAJDAR	BEJDO	VLADIMIR	SHABAN	PASMACIU
YMER	NURI	HASANI	AGIM	QANI	TAMO	DUSHI	XHEVIT	BREGU	ARDIAN	LEFTER	BUBA
AHMET	ISMAL	ALAMETI	ERMAL	HAZIS	HAZIZAJ	LEVANT	DUSHI	BREGU	FIQIRI	NAZIF	SADIKU
AJET	QAZIM	VAVLA	ARSHIN	HEKURAN	RAMA	SEVRAN	YMER	GAJTA	ENEO	BRAHIM	HALITAJ
ANA	LEKO	VAVLA	BLENDAR	AGIM	AZIZI	ARTAN	NEXHIP	SELAMI	BRAHIM	AVNI	HALITAJ
ARBEN	PALI	KARAKASHI	MILTJADH	NAUN	NAÇO	HAJDAR	LUTO	LIKAJ	MKEL	FADIL	ISOLLARI
LILI	PALI	KARAKASHI	MYNYR	HAZIS	HAZIZAJ	PELLUMB	BARJAM	PLEPI	JANULLA	DALIP	PAPA
GEZIM	RAMADAN	LOPARI	FATMIR	HAZIS	HAZIZAJ	BILBIL	HAZIS	HAZIZAJ	ILIR	ALUSH	BRAMI
ALIT	QEZAR	BAKU	JANI	LUTO	HEÑA	SALI	ABDYL	ISUFAJ	ALUSH	ARSHIN	BRAMI
DASHURI	XHEVIT	BAKU	VASIL	JANI	PJETRI	RAMIS	GANI	DOLLANI	FLAMUR	REXHEP	MISHOVA
LATIF	HASAN	FILE	ANASTASIA	SOTIR	PJETRI	GEZIM	TEFIK	BEJDO	EDMOND	QANI	OMERI
ARMANDO	LATIF	FILE	KOMUNITETI MUSLIMANI SHQIPERISE, MYFTINIA			FATJON	XHINDI	XHINDI	ARTA	FLAMUR	OMERI
LEFTER	NEKI	CENOLLARI	BERAT			MARSELA	XHINDI	XHINDI	SHEGE	IZET	ZEQAJ
BESIM	MURAT	DELIBASHI	SHEZAI	SHAQIR	AZIZI	FATJON	XHINDI	XHINDI	FLORESHA	ZEQO	ZEQAJ
BEDRI	JASHAR	TOSKA	SOFIJE	ADIL	BASHA	SABIRE	MEHDI	XHINDI	ARBEN	ZEQO	ZEQAJ
FLORENC	PETRIT	BENISHTA	BILBIL	RIZA	HAZIZI	SONILA	NAZMI	XHINDI	VULLNET	ZEQO	ZEQAJ
LEON	HASAN	RAMO	ARJANA	RUSTEM	RAMO	RAJMONDA	NAZMI	XHINDI	VEXHI	SHERIF	HOXHA
HASAN	SHEME	RAMO	FREDI	ISMET	RAMO	GRAMOS	XHEVIT	CALLMORI	VANGJEL	DULE	GRAMATIKO
BLENDAR	EQEREM	FAJRE	MIRAKAJ	ISMET	RAMO	MUHAREM	RAPO	KOKA	VLADIMIR	LAZAJ	KOKA
XHEVAIR	JONUS	CIBUKU	QETSOR	BATJAR	HOXHA	PETRIT	MYNYR	SULOVARI	BUJAR	NAZIF	MININI
NANI	KUTJUS	DUCI	BATJAR	KAJMAK	HOXHA	QAMIL	MYNYR	FIKAI	ARTAN	XHAFER	DINGO
SADIK	SALI	DUCI	ERJON	AHMET	OSHAFI	SYBIE	MUHAREM	FIKAI	EDUARD	XHAFER	DINGO
MYRTEZA	MECAN	SHEQERI	AHMET	IBRAHIM	OSHAFI	EMILJANO	KUTJUS	TOSKA	FERDINAND	HAXHI	LUARI
KODHEL	METI	RAMO	BURAN	BESNIK	MALASI	VASIL	NAZIF	SALAJ	SOTIR	VANGJEL	GRAMATIKO
EQEREM	SHFIT	MIRAKAJ	HAXHI	YZEDIN	YEDIN	EDMOND	RAMADAN	SENKA	NIKO	FAIK	NAKSI
GEZIM	PELIVAN	RIPAJ	BASHKIM	RUSHIT	FLEPI	FLORESHA	QEMAL	SENKA	SOKOL	FAIK	NAKSI
GEZIM	PELIVAN	RIPAJ	KOSTANDIN	JORGJI	QEMERI	IZET	FETAH	MEMISHI	SOKOL	VANGJEL	GRAMATIKO
ILIR	PELIVAN	RIPAJ	AVDULLA	JONUS	VRAPI	VALTER	MESTAN	BRAMI	VASIL	HAJREDIN	KATI
FATMIR	NOVRUS	SULO	JANI	ISA	VOJKU	MESTAN	ZEJNEL	BRAMI	VLADIMIR	DILAVER	ZOGA
VULLNET	RAMADAN	LOPARI	BARIE	LAZE	VOJKU	HYSNI	ZEJNEL	BRAMI	KIMETE	KADRI	ZOGA
SAIMIR	ABEDIN	ORIZI	ISA	QAZIM	VOJKU	MEHMET	HEKURAN	GANI	GANI	IZET	MINGU
ABEDIN	HEKURAN	ORIZI	IBRAHIM	SALI	KRAPS	ELIAN	LUAN	QAZIMI	ILIR	HASAN	HOXHA
AGIM	SHAHIN	MUCA	ALI	HAJRO	HASANAJ	FJODERISA	GEZIM	MBOLANI	JOLANDA	HETEM	KECYRA
VELI	BARJAM	AVDIU	ZENEL	IDRIS	BEJDO	ILIRJAN	MAHMUT	QOLJA	ANTEJOAS	ASTRIT	KELCYRA
BUKURUE	ILJAS	BREGU	LUTFLIE	ISUF	BEJDO	GEZIM	SULO	TOSKA	ARTJOL	ASTRIT	KELCYRA
NAZMI	BEQAR	BREGU	HALIT	RIZA	SELAMI	BARJAM	FILE	RRIPI	AFERDITA	MUHAMET	LESKAJ
KRENAR	BEQAR	BRAKA	ALI	ISMAL	DELIBASHI	LUTO	SHABAN	CALA	EQEREM	HAKI	XHINDI
KRENAR	METI	RAMO	LEFTER	MURAT	DELIBASHI	RONI	MENTOR	ZHOPI	ESMERALDO	BEKTASH	HAJDARASI
FATMIR	SABRI	HOXHAJ	BUJAR	ESAT	KALECI	ALEKS	ISUF	KOLA	SHYQYRI	BEKTASH	HAJDARASI
LEFTER	NASIBI	SHAMO	ESAT	SALI	KALECI	FERBENT	XHEVIT	ZHUKA	EGLANTIN	KADRI	DELIBASHI
KRISTO	SPIRO	HAXHISTASA	BARJAM	MUSTAFA	KALLMI	LINDITA	ISUFAJ	BUJAR	BUJAR	JASHAR	HOXHAJ
ILJAZIM	IZET	MYRTAJ	BILBIL	SAKO	DOSTI	ARGITA	AGIM	ZALO	VLADIMIR	QAZIM	MUKA
MUSTAFA	IZET	MYRTAJ	AGIM	OSMEN	PASHA	ANXHELA	AGIM	ENVER	ANDREA	METE	HOXHA
JULJAN	ADEM	SELAMI	AGIM	ISMAL	GJECI	ELO	AGIM	ISUFAJ	ANDREA	LAYER	HOXHA
ADEM	NEIM	SELAMI	JULIAN	AGIM	GJECI	DULE	AGIM	KANACI	LAVER	MERSIN	HOXHA
SHABAN	IBRAHIM	OSHAFI	SANIJE	HYSNI	DUCI	LAVDIMIR	DULE	KANACI	XHEVDET	QAZIM	LIKAJ
LAVDIMIR	TEFIK	BEJDO	ERIDJOL	ROLAND	DUCI	LUAN	MESTAN	BRAMI	LUAN	XHAFER	XHINDI
TEFIK	SELM	BEJDO	ZYDI	SHYQYRI	KERPICA	ARBRI	ZEJNEL	BRAMI	ARBRI	LUAN	XHINDI
ISA	KALEM	KOSOVA	REFAT	RAMADAN	GEGA	SULMOR	FATMIR	BANI	SULMOR	NEXHIP	KINCE
GAZMENT	ARIF	DELIBASHI	SEFER	IBRAHIM	SENKA	FATMIR	TAJAR	BANI	ALTIN	KASEM	SPAHIU
KRENAR	HAJDAR	RUCI	ELTON	FATMIR	CEPELE	ELTON	BRAHIM	GEGA	KASEM	SHYQYRI	SPAHIU
KADRI	HAJDAR	SALAJ	AVDYLL	RUSTEM	BRAMI	ENTELE	PETRIT	GEGA	ALKETA	KASEM	SPAHIU
GEZIM	NURCE	GJISHTI	FERAT	IDRIS	ZANI	REXHEP	MUHAREM	MOLLAJ	ERISELDA	KASEM	FEJZOLLARI
JANI	NURI	MIMANIS	KRENAR	ASQERI	PLAKU	ELMAS	FLAMUR	MURATAJ	KASTRIOT	NASI	NANO
HAJDAR	KAMBER	METKAJ	KRISTO	ISUF	KOLA	ILIR	DINGO	DINGO	ARTUR	BARDHOSH	HASANAJ
ARIAN	BURHAN	KAFAZI	SHFIT	DYLBBER	OSMANI	IDARIK	XHEVIT	ZHUKA	HYSNI	GANI	XHINDOLI
IZOTA	BAJRAM	KAFAZI	ALTIN	RAPO	ZHOPI	KASTRIOT	BEKTASH	BAKIU	LUAN	GANI	XHINDOLE
XHEMLE	RIZA	FIRAKU	GERALD	SYBI	SHYTI	AGRON	RESHAT	AGO	NAMIK	SHAQIR	HOXHA

SPECIALE DENIMI I KADRI HAZBIUT

Ekskluzive / Raporti "Tepër sekret" i anëtarit të Byrosë Politike, lidhur me aktivin e Pogradecit për "Tablonë sinoptike..."

Spiro Koleka: Kuadrot e Pogradecit që folën për Mehmetin e Kadriun si armiq

"Kadri Hazbiu ka ardhur me ish-tregtarin milioner nga Durrësi, Manushi"

Nga Dashnor Kaloçi

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohesh; "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet Shehu", të cilat do t'i shërbenin më pas Enverit për të shkruar "Tablonë sinoptike për poliagjentin Mehmet Shehu"? Në të gjitha këto mbledhje, veç të tjerash, ashtu siç bëhet e ditur edhe nga një mori dokumentesh me siglën "Tepër sekret", që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëmarrës e diskutantë të shumtë që kanë marrë fjalën aty, kanë hedhur lloj-lloj akuzash, me të vërteta dhe të pavërteta, denoncime, spiunime, shpifje, trillime, thashetheme, intriga, sajesa e gjithfarë u kanë ardhur për shtat, të gjitha këto në drejtim dhe kundër ish-kryeministrit të vdekur, Mehmet Shehu, familjes së tij dhe atyre që u konsideruan bashkëpunëtorë të tyre, duke përmendur me dhjetëra emra, ushtarake, funksionarë të lartë, etj. etj. Po kështu, këto mbledhje u intensifikuan së tepërmi, sidomos pas tetorit të vitit 1982, kur u arrestua dhe ministri i Mbrojtjes Kadri Hazbiu, (i cili për gati tri dekada me radhë kishte mbajtur postin delikat të ministrit të Brendshëm), ku dhe

ndaj tij, u përsërit e njëjta tablo, si me ish-kryeministrin Mehmet Shehu. Dhe pas zhvillimit të këtyre mbledhjeve, komitetet e partisë të rretheve përkatëse, kanë hartuar një sërë raportesh me përmbledhje nga "problemet më kryesore", të cilat më pas ia kanë dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së. Për të gjitha këto mbledhje, gazeta "Panorama" disponon një numër të madh dokumentesh të nxjerr nga një dosje voluminoze me siglën "Tepër sekret", ku ish-anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të Komitetit Qendror të asaj kohe, si Spiro Koleka, Enver Halili, Vangjel Çerrava etj., etj., informojnë Komitetin Qendror për mbledhjet ku kanë marrë pjesë, duke dhënë me detaje dhe hollësi gjithçka është thënë dhe diskutuar aty. Po kështu përveç këtyre raportesh, në dosjen në fjalë, gjenden edhe një sërë raportesh të hartuara nga funksionarë të rangjeve më të ulta që nga Komiteti Qendror e më poshtë, apo dhe raporte kolegjiale të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe, shtabeve, komandave dhe komiteteve të partisë së Korpusve ushtarake, që ishin edhe njësitë më të mëdha që kishte Ushtria shqiptare asokohe. Nga kjo dosje voluminoze që "Gazeta Shqiptare" e disponon të plotë, në numrin e sotëm fillimisht po publikojmë



Spiro Koleka

raport-informacionin e ish-anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së, Spiro Koleka, dërguar Komitetit Qendror, lidhur me aktivin e partisë të rrethit të Pogradecit, ku ai ka marrë pjesë si i deleguar, më 25 shtator të vitit 1982. Për të vazhduar në numrat në vijim, (në tri shkrime radhazi) me raport-informacionin "Tepër sekret" të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Korçës, Enver Halili, dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së

(personalisht Enver Hoxhës) lidhur me punën dhe veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Korçës si dhe "impikimin" e Mehmet Shehut, Kadri Hazbiut, Feçorr Sheut etj, me punonjës të Sigurimit dhe persona të tjerë në atë rreth dhe më gjerë.

(vijon nga numri i kaluar)

PARTIA E PUNES SHQIPERISE
Tepër sekret
KOMITETI I PARTISE
RRETHIT Ekz. Nr. 1
Nr. 675 Prot. Pogradec, më 28.9.1982

L e n d a : Informacion
"Mbi punimin e vendimit të Plenumit të KQ të PPSH"
KOMITETIT QENDROR
TE PPSH SHQIPERISE
GRUPIT TE INSTRUKTOREVE
TIRANE

N j o f t i m
Mbi zhvillimin e Aktivit të Partisë të Pogradecit datë

18 tetor 1982 rreth veprimtarisë armiqësore të Kadri Hazbiut

Sapo mora porosinë, udhëzimet përkatëse dhe raportin e Byrosë Politike mbi veprimtarinë armiqësore të Kadri Hazbiut, të mbajtur në Plenumin e V-të të Komitetit Qendror të Partisë, njoftovë menjëherë në telefon sekretarin e I-rë të Komitetit të Partisë të rrethit se rreth orës 17 do të isha atje.

Dhe në orën 17 e 15 të datës 16 m.v. mbrita në vend.

Shoku Stili Kaskaviqi më priste. E vura në dijeni pasi shkova atje. Ai ishte njoftuar për aktivin nga Komiteti Qendror i Partisë dhe kishte marrë masat për të lajmëruar ata që do të merrnin pjesë në aktiv. Shoku Stili më vuri në dijeni se paradite në Plenumin e zgjeruar të rrethit, ku kishin marrë pjesë rreth 180 veta, sekretarët e Byrosë së Partisë etj, u kishte folur shoku Enver Halili mbi punimet e Plenumit të V-të të Komitetit Qendror të Partisë, në veçanti mbi veprimtarinë armiqësore të Kadri Hazbiut e mbi vendimet që morri plenumi.

Bashkë me shokun Stili Kaskaviqi e Spiro Pici nga ora 19.00 deri në ora 20.30 shkuan në mbrëmjen e kolektivit të Parkut Automobilitik me rastin e ditëlindjes së shokut Enver Hoxha e të kremtimit për marrjen e flamurit të Ministrisë së Komunikacionit. Për dorëzimin e këtij flamuri kishte qenë në vënd një ditë më parë shoku Luan Babameto, i cili u kishte të mbi zhvillimin e mëtejshëm të transportit, që shqyrtoi Plenumi i V-të i Komitetit Qendror të Partisë.

Gjatë mbrëmjes shumë të gëzuar të shoferëve dhe punëtorëve të këtij Parku pararojë u ngritën shëndete plot zjarr për Partinë e



Kadri Hazbiu në gjyq

shokun Enver Hoxha. Në shëndetin që ngrija unë për shokun Enver, theksova fitoren e madhe që vlosi Plenumi i V-të i Komitetit Qendror të Partisë me zbulimin e tradhëtisë së Kadri Hazbiut dhe vendimet e tjera për spastrimin e Komitetit Qendror të Partisë nga anëtarë, të cilëve u kishte munguar vigjëlencia dhe masat e tjera për forcimin e Partisë. Të pranishmit pritën me brohëritje të stuhishme këtë fitore tjetër kundër varmiqëve të betuar të Partisë dhe morrën zotime luftarake për rritjen e vigjëlencës e për plotësimin e të gjitha detyrave që u ngarkonte Kongresi i 8-të i Partisë e Plenumi i V-të i Komitetit Qendror të saj. Mbrëmja u elektrizua edhe më shumë nga siharigji që u njoftua.

Aktivt zhvilloi punimet më datën 18 m.v. nga ora 9.00-12.00.

Në aktiv merrnin pjesë rreth 480 veta anëtarë të Plenumit të Komitetit të Partisë së rrethit, sekretarët e byrove dhe të organizatave-bazë të Partisë, kuadro me parti e pa parti të organeve të pushtetit nga rrethi e nga baza, kuadro të organizatave të masave, veteran e pensionistë etj.


Pasi i njoftoi shoku Stili Kaskaviqi mbi qëllimin e aktivitetit e i porositi të mbanin shënime, pse raporti i Byrosë Politike nuk do të punohet në organizatat bazë, por ato do të njoftoheshin në mbledhjen e tyre të rregullt të parë, do të njoftoheshin gjithashtu edhe punonjësit, fillova këndimin e raportit meqendalë e me theksimin që kërkon rasti. Raporti, për afro një orë e njëzet minuta, u ndoq me vëmendje të veçantë.

Pastaj shoku Stili dha porosi që, kush kishte pyetje, t'i dorëzonte në sekretari dhe u bënë 20 minuta pushim.

I. Pas pushimit ishin



Spiro Koleka



dhënë vetëm këto dy pyetje me shkrim:

1. A ka dalë gjë për Nako Spiron?
2. Të sqarohet përgjegjësia që ka Veli Llakaj, Nazar Berberi dhe Ndreçi Plasarin.

Njoftuan aktivin mbi këto dy pyetje e kërkuan prapë "kush ka pyetje të tjera?" Ndrëçkaq unë dhashë sqarime për të dy pyetjet e para: Për Nako Spiron nuk ka dalë ndonjë gjë e re e si rrjedhim mbetet gjykimi i njohur i Partisë rreth tij. Për Veli Llakajn, Nazar Berberin e Ndreçi Plasarin, thashë se atyre u ka munguar vigjilënca e janë përlayer me super-agentin Mehmet Shehu etj. Sa janë përlayer, këtë do ta tre-

goj jeta. Sot këto dihen, etj. Pas sqarimeve që dhashë unë u bënë edhe këto pyetje me gojë:

1. Enver Halili na tha "këlyshë" për Veli Llakajn e Nazar Berberin. Si t'u themi?
1. Kemi dëgjuar se Nesti Nase është arrestuar? Pse?
2. A kanë vrrarë shokë besnikë të partisë këta super-agentja dhe agjentë?
- U dhashë këtë gjegjë: **Veli Llakaj e Nazar Berberi** nga Plenumi u dënuan për mungesë vigjilënce dhe unë u thashë "janë përlayer" e "këlyshë" mund të thuhet, por ende për ata nuk ka dalë ndonjë gjë që të tregojë se kanë qënë bashkëpunëtorë të ndërjegjshëm, ose qen që kanë kafshuar bashkë me ustanë, që të merrej edhe

masa për t'u dorzuar organeve të drejtësisë.

Për Nesti Nasen, thashë, se ai është arrestuar si bashkëpunëtorë i Mehmet Shehut në punët e tij agjenturore me jashtë. Veli Llakaj e Nazar Berberi nga Plenumi u dënuan për mungesë vigjilënce dhe unë thashë "janë përlayer", shoku Enver Halili tha "janë këlyshë", "përlayer", e "këlyshë" mund të thuhet, por ende për ata nuk ka dalë ndonjë gjë që të tregojë se kanë qënë bashkëpunëtorë të ndërjegjshëm, ose qen që kanë kafshuar bashkë me ustanë, që të merrej edhe masa për t'u dorzuar organeve të drejtësisë.

Për Nesti Nasen, thashë se ai është arrestuar si bashkëpunëtor i Mehmet Shehut në punët e tij agjenturore me jashtë. Që këta stëragjentë e agjentë kanë vrrarë njerëz besnikë të Partisë s'ka se çu luan, sepse ata për 40 vjet me rradhë, por sa, cilin, kur, e ku kanë vrrarë, kjo ende nuk ka dalë. Sapo kemi futur gishtin në kërkimet rreth veprimtarisë armiqësore të kësaj bande. Kërkimet janë në vazhdim e do të vazhdojnë. Në sqarimet që dhashë përmenda të gjitha ato që dolën në Plenum rreth bastuneve-pushkë të precizionit e pushkëve të Mehmet Shehut e diplomës mbi rrëshqitjen që lidhen me Veli Llakajn e atë të tankeve për Nazar Berberin, për të cilat një pjesë u kishte folur edhe shoku Enver Halili. Kështu edhe për Ndreçi Plasarin thashë ato që dolën në Plenum.

Nga këto pyetje, e nga këmbëngulja sidomos rreth Veli Llakajt e Nazari Berberit, kuptova se Partia është e shqetësuar e kërkon të vihet në dijeni në vazhdimësi e më shumë nga Komiteti Qëndror mbi këtë komplot të madh. Pyetja rreth arrestimit të Nesti Nases, sipas meje, do të thotë: "fjala mbi arrestimin e tij ka dalë por neve Partia nuk na ka thënë gjë deri më sot". Një pyetje tjetër (e gjashta) doli gjatë kohës

që folën disa shokë: A kishte dijeni Kadri Hazbiu për zbritjen në anë të detit të bandës së armiqeve?

Për këtë u thashë se logjika të çon të mendosh që Kadri Hazbiu, krahu i djathtë i Mehmet Shehut e vazhdues besnik i tradhëtisë së tij të madhe, mund edhe të ketë kërkuar nga ata që e drejtojnë të dërgojnë një bandë, pikërisht në ato ditë që në Parti punohej fjala e shokut Enver Hoxha në Plenumin e IV-të të Komitetit Qëndror. Këtyre u shvota ato që kisha dëgjuar: ai ishte dërguar në rrethin e Elbasanit për aktivitetin e Partisë dhe sapo e mbaroi shkoi në Rrogozhinë si shumë i shqetësuar e kërkoi të hynte në shtëpinë, ku ishte futur e bënte qëndresë kryetari i bandës, por këtë nuk e pranoi shoku Hekuran. Këto dëshmojnë, përfundova, se Kadri Hazbiu kishte dijeni për bandën, e kërkonte dhe donte të dilte si hero i ditës e shpëtimtari i situatës, me qëllim që të mashtrohte edhe më tej Komitetin Qëndror të PPSH-së e të humbiste gjurmët.

II. Në aktiv folën tetë shokë:

Të gjithë i gjetën shumë me vënd masat e marra nga Plenumi kundër armikut të betuar Kadri Hazbiu e dorzimin e tij organeve të drejtësisë dhe ato kundër katër antarsë të K.Q. të Partisë. Të gjithë i mbështetën njëzëri ato, raportin e Byrosë Politike e zhvillimin e punimeve të Plenumit. Të gjithë shprehën urrejtjen më të madhe kundrejt kësaj bande armiqësore në shërbim të të gjithë agjenturave imperialiste-revizioniste dhe kërkuar që shpata e drejtësisë proletare të bjerë e pa mëshirë mbi ta. Të gjithë ata që folën kërkuar që gjërave t'u shkohet në fund e të spastrohen me fshesë të hekurit aparati i Ministrisë së Punëve të Brëndshme, në qëndër e në rrethe, dhe ai i Edrnisë së Mbrojtjes, por edhe ai i Ministrisë së Jash-tme.

Shokët folën me zjarr, dashuri e mirënjohje të pafund për Partinë e në veçanti për shokun Enver Hoxha, që ka shpëtuar gjithmonë Partinë e diktaturën e proletariatit nga rreziqe shumë të mëdha që i kanë kërcënuar gjatë këtyre 41 vjetëve të lavdishëm të jetës së Partisë. Të gjithë ata që folën, falenderuan K.Q. të Partisë për këto njoftime, premtuan se do të rritnin shumë më shumë vigjilencën ashtu siç e lypin koha e gënia e tyre rreth kufitar me tistë jugosllavë dhe morën zotime të plotësojnë detyrat për fushatën e zgjedhjeve për deputetë, për përgatitjen e tyre ushtarake e për përmblidhjen e planit. Aktivi u kthye në një shfaqje të zjarrtë të unitetit të Partisë rreth K.Q. me shokun Enver Hoxha në krye.

Nga ato që thanë shokët që folën mendoj se mund të shërbejë këto:

Çelik Toro: Drejtor i Ndërmarrjes së Përpunimit të Drithit tha: "Rreth vitit 1960, Kadri Hazbiu ka ardhur në Pogradec me ish tregtarin milioner nga Durrësi Manushi. Ka pasur miqësi të madhe me të, pse ka qënë mik i ngushtë i të birit në Shkollën Tregtare, pse vetë Kadri Hazbiu ka qënë djali i një pasaniku".

Behar Çela: Sekretar i byrosë së Kooperativës Buci-masit kërkoi: "të dënohet çdo veprimtari që çon në privilegje".

Syria Çarçani: Sekretar i byrosë së Degës së Punëve të Brëndshme tha: "Të thellohen kërkimet për të gjitha ato kuadro që kanë qënë në Ministrinë e Punëve të Brëndshme, sa e si janë përlayer këta armiq të betuar. Të shihet mirë edhe politika e kuadrit, pse nuk janë vënë veçse nga njerëz në këto ose ato vënde ku ndodhen sot kuadrot".

Nuçi Tira: Pensionist, pasi tha se ka njohur Kadri Hazbiun që në vitin 1945 si njeri të zgjuar e gjarpër, shtoi: "Në vitin 1956 në Durrës është goditur një grup intelektualësh i njohur me emrin "gjqqi i inxhinierëve", këta thoshin "në krye kemi njerëzit tanë të mëdhenj". Këtë e kapi menjëherë Mihallaq Zicishti e Kadri Hazbiu i cili shkonte dy herë në ditë në Durrës, e mbuluan". Nuçi, pas kësaj shtoi: "Të shikohet dosja e Gjyqit të Inxhinierëve në Durrës në 1956. Ajo ndodhet në Ministrinë e Brëndshme". Më tej Nuçi tha: "Mehmet Shehu ka vrrarë njerëz të pafajshëm. Këtë e kam parë gjatë Luftës për çlirimin e Tiranës, pushkatoi pa gjyq një puntor dhe katër inxhinierë". (Me këtë rast, shoku Stili i tha: "Mendohu mirë e thellohu mbi këtë që thua, e na i jep me shkrim më të saktë këto").

Polikron Çe: ish Drejtor i Ministrisë së Alarupit, tani në pension, pyeti Nuçi Tiranë: "A ia ka thënë Partisë atë që ke dëgjuar atëherë nga

inxhinierët që kemi njerëz tanë të mëdhenj në krye?" Nuçi iu përgjigj: "Unë tani e kam marrë vesh se Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu, Mihallaq Zicishti etj, janë armiq".

III. Rezoluta që paraqiti Komiteti i Partisë u miratua me brohoritje për Partinë e për shokun Enver Hoxha. Pas kësaj fola edhe vetë, rreth 20 minuta, në frymën e porosive që na dha shoku Enver në hyrje e në mbyllje të punimeve të Plenumit, krejtësisht rreth çështjes së veprimtarisë armiqësore të Kadri Hazbiut.

1. Po kështu nuk kishte problem përkatësisht me fushatën e zgjedhjeve për deputetë. Ditën e dielë kaloi edhe shoku Rita Marko për në Korçë dhe la porosi që në kthim të mblidhjeve grupi i rrethit që ndjek punët e zgjedhjeve për t'i raportuar. Disa mendime dhishë edhe vetë për t'i forcur punën në komisionet e zgjedhjeve të zonave që të japin më shumë ndihmë të organizuar qëndrave të votimit.

Nga shkëmbimi i mendimeve me shokun Stili del se gjëndja politike në rreth është e mirë. Nuk qarkullojnë parulla armiqësore por armiqet ndërmjet tyre tani kanë marrë në mbrojtje armikun Mehmet Shehu, e kundërta e asaj që bënin kur ishte gjallë, atëherë e shanin.

Gjëndja në kufi ishte e qetë. Ditën e dielë pati një rënie zileje në klon por ngatërrim në një gjatësi 5 km. sipas rregullave nuk u gjend asnjë gjurmë. Po kështu gjatë pushimit në aktiv erdhi një njoftim se në afërsi të një pylli (ku kanë kaluar bandit e kanë pasur strehë) ishin parë tre të panjohur. Me lejen e sekretarit të pare, Kryetari i Degës së Brëndshme iku nga aktiviteti për në vënd. Pasdrecke pieta shokun Stili: "Ç' doli? Më tha asgjë.

Duke folur me shokun Stili i thashë se Tirana në televizion shihet mirë në Pogradec. Shoku Stili më tregoi se përpara nuk shihet mirë. Kontrolluam stacionin përforcues dhe duke lëvizur antenën gjëtm vendosjen që duhej e prej atëherë e shohim shumë mirë Tiranën. Por që atëherë kemi dëgjuar ankime nga shqiptarët tej kufirit, të cilët antenan e tyre i kanë drejtuar nga përforcuesit e Tv të Tiranës. Tani jemi duke ndërtuar antenën e Cervenakës, e cila do të shërbejë rrethet Kolonjë, Korçë, e Pogradec dhe më gjërë e më mirë shqiptarëve të Maqedonisë e atyre përtej Devollit. E pieta: "A është bërë rruga për në stacionin e antenës dhe kur mbaron". Rruga është e bërë më tha, e luftojmë ta mbarojmë për festat e Nëntorit.

Mendoj se K.Q. të udhërojë të shpejtohen sa më shumë punimet për vënien sa më parë të kësaj antene në shfrytëzim sidomos për shqiptarët e Jugosllavisë e të Greqisë.

Tiranë më 19.10.1962
Spiro Koleka



Enver Hoxha, Kadri Hazbiu

Dimitri Avramopolus: Vendimi i PE, dritë e gjelbër e fuqishme

Komiteti i Parlamentit Evropian voton: Kosova e lirë në Shengen

Johannes Hahn: Votim pozitiv dhe i merituar

Pas një odiseje të gjatë lidhur me debatin për kufirin me Serbinë dhe ngërçin politik të brendshëm, më në fund, një lajm i mirë për Kosovën. Ditën e djeshme, Komiteti për të Liritë Qytetare, Drejtësi, dhe Çështje të Brendshme - LIBE, në Parlamentin Evropian, ka votuar pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Me 30 vota pro, 10 kundër dhe 2 abstenime, ky komitet i PE-së ka kaluar çështjen e liberalizimit për kosovarët tek Parlamenti Evropian dhe Këshilli për Marrëveshje Nder-institucionale për Liberalizim. Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha gjendet në Bruksel, ku gjatë ditës së mërkurë ka takuar zyrtarët e Parlamentit Evropian për vizat. Hoxha ka takuar eurodeputetën Tanja Fajon, si dhe në takime të ndara, ka takuar eurodeputetët Marie Christine Vergat, Angelika Mlinar dhe eurodeputetin Asim Ademov, të gjithë anëtarë të Komisionit LIBE me të cilët u rikonfirmua mbështetja për liberalizimin e vizave për kosovarët. BE ka hedhur hapin e parë drejt heqjes së vizave për qytetarët kosovarë. Raporti i Komisionit Evropian, të paraqitur më 18 korrik, u miratua dje, ku thuhej se Kosova i kishte përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Për raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian Tanja Fajon, nuk ka më asnjë arsye që institucionet përgjegjëse të unionit të pengojnë procesin e heqjes së vizave. "Ata nuk kanë asnjë arsye që ta kundërshtojnë këtë pasi Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret. Ne po e bëjmë këtë për njerëzit e zakonshëm, për të rinjtë, për ata që sot poshtërohen para konsullatave, sepse thjeshtë nuk mund të udhëtojnë në vendet evropiane". Debatimi nisi në orën 09:00, dhe sipas axhendës ishte i paraparë që të zgjasë deri në orën 12:30, axhenda përmbante gjithsej 12 pika, Kosova figuronte në pikën numër 7. Eurodeputetja dhe raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, para anëtarëve të Komitetit kërkoi votën e tyre për rekomandimin e vizave pasi, siç tha ajo, Kosova ka bërë rrugë të gjatë deri tek heqja e vizave. "Do të doja të falënderoja të gjithë ata që kanë kontribuar, sepse e di që ka qenë rrugë e gjatë dhe është hap i rëndësishëm për Kosovën që ka qenë e izoluar për një kohë të gjatë. E di sa e vështirë ka qenë dhe e di se sa shumë kanë punuar. Ju ftoj që ta përkrahni Kosovën për liberalizimin e vizave", -ka thënë Fajon para votimit. Ndërkaq për optimizimin e shprehën në një



Komiteti i Parlamentit Evropian

JOHANNES HAHN:

"Një votë shumë e mirëpritur nga gjykatat e Parlamentit Evropian. Shpresoj për një vendim të shpejtë të favorshëm dhe të merituar edhe nga Këshilli i Komisionit Evropian.", shkruan në 'Twitter' Komisioneri për Zgjerim në BE, Johannes Hahn.

"SHBA ka ndryshuar qëndrim lidhur me Ballkanin"

Gerald Knaus: Shkëmbimi i territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë sjell konflikte



GERALD KNAUS:

"Kjo metodë krijon konflikte të reja në Ballkan dhe na kthen në vitet 1980, kur intelektualët dhe politikanët e ish-Jugosllavisë, në vend të debatit për reforma, kanë folur për kufij dhe çështje etnike. Të gjithë e dimë se si ka përfunduar kjo", -tha Knaus, raportori Shërbimi i Ballkanit i Radio Evropa e Lirë. Ai po ashtu tha se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk ka mandat nga Kuvendi i Kosovës për të diskutuar rreth shkëmbimit territorial dhe shtoi se ndryshimi i kufijve nuk u shërben interesave të serbëve që jetojnë në pjesë të Kosovës

dhe duan bashkimin me Serbinë. "Fati i serbëve në Kosovë dhe i shqiptarëve që jetojnë në Serbi nuk duhet të varet nga qeveritë e tyre", tha Knaus. Ai tha se administrata amerikane e ka ndryshuar qëndrimin për këtë çështje dhe se nuk është aq e interesuar për Ballkanin.

Kur bëhet fjalë për Rusinë, Knaus tha se Moskë dëshiron të pengojë integrimin e Ballkanit në BE.

reagim në 'Twitter', edhe komisionerët Hahn e Avramopolus. Komisioneri Evropian për çështje që lidhen me migracionin, Dimitri Avramopolus, ka mirëpritur vendimin e Komitetit LIBE për liberalizimin e vizave për Kosovës.


Përmes një postimi në 'Twitter', ai ka shkruar se pret që ky vendim të shpejtojë të jetë për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor për lëvizje të lirë pa viza. "Mirëseardhje për një dritë të gjelbër të fuqishme nga Komiteti LIBE për të

filluar negociatat me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave për Kosovën. Shpresoj se ky vendim të shpejtojë të jetë për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor për lëvizje të lirë pa viza", ka shkruar Avramopolus në logarinë e



TANJA FAJON:

"Do të doja të falënderoja të gjithë ata që kanë kontribuar, sepse e di që ka qenë rrugë e gjatë dhe është hap i rëndësishëm për Kosovën që ka qenë e izoluar për një kohë të gjatë. E di sa e vështirë ka qenë dhe e di se sa shumë kanë punuar. Ju ftoj që ta përkrahni Kosovën për liberalizimin e vizave", -ka thënë Fajon.



DIMITRI AVRAMOPOLUS:

"Mirëseardhje për një dritë të gjelbër të fuqishme nga Komiteti LIBE për të filluar negociatat me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave për Kosovën. Shpresoj se ky vendim të shpejtojë të jetë për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor për lëvizje të lirë pa viza", -ka shkruar Avramopolus.

Të pyeten emigrantët për Shqipërinë, Salvini: Çmenduri!

MATEO SALVINI:

"Në Europë nuk lëvizin një gisht për t'i pranuar, por indinjohen nëse shkojnë në Shqipëri, sepse 'duhet leja e tyre'. Ku jemi, në një fshat pushimesh? Çmenduri..." shkruan ministri i Brendshëm italian në 'Facebook'.

Matteo Salvini, ministri i Brendshëm italian, ka reaguar pas deklaratave të Bashkimit Evropian, sipas të cilit, 20 emigrantët afrikanë duhet të pyeten nëse duan të shkojnë apo jo në Shqipëri. Përmes një postimi në "Facebook", Salvini i konsideron çmenduri deklaratat të tilla. "Në Europë nuk lëvizin një gisht për t'i pranuar, por indinjohen nëse shkojnë në Shqipëri, sepse 'duhet leja e tyre'. Ku jemi, në një fshat pushimesh? Çmenduri..." shkruan ai në "Facebook", ndërsa bashkëngjitur ka postuar lajmin e BE ku flitet për marrëveshjen me Shqipërisë e Italisë për strehimin e 20 emigrantëve nga Afrika në vendin tonë.

tij në Twitter. Ndërsa një reagim ka ardhur edhe nga Komisioneri për Zgjerim në BE, Johannes Hahn. Në një postim në Twitter, Hahn thotë se votimi ishte shumë pozitiv. "Një votë shumë e mirëpritur nga gjykata e

Parlamentit Evropian. Shpresoj për një vendim të shpejtë të favorshëm dhe të merituar edhe nga Këshilli i Komisionit Evropian.", shkruan në twitter komisioneri për Zgjerim në BE, Johannes Hahn.

TAKTIKA TË ÇUDITSHME PËR DOBËSIM QË VËRTET FUNKSIONOJNË

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E premte 31 Gusht 2018



**PSE NUK FLASIN LEDIONI
DHE ARBANA**



**Beatrix Ramosaj në një
lidhje? Reagon këngëtarja**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Rama godet sërish me veshjen, kravatë me Homer Simpson që vrapon lakuriq
- Meta me Dardarin përshëndet nga Jezerca me duart si shqiptonjë
- Mesazhi i Tahirrit: Kanë rënë çatitë, por mbahen themelet
- Presidenti Trump në daljet publike shoqërohet nga zozia e Melanie?



Muzika bashkimi i shpirtrave të tyre, këngët që do mbeten hit

**Zbulohet arsyeja e
ndarjes së Seldi Qallit
me Mimoza Shkodrën**

Ja marrëdhëniet e dështuara të këngëtarit

Muzika bashkimi i shpirtrave të tyre, këngët që do mbeten hit

Zbulohet arsyeja e ndarjes së Seldi Qalliut me Mimoza Shkodrën

Ja marrëdhëniet e dështuara të këngëtarit



mbajë veten larg thashemeve duke e ruajtur me fanatizëm jetën private. Fryti i dashurisë së tyre qenë këngët "Pare pare", "Dashni", si dhe e fundit para dy muajve "Sa kujtime". Seldi është i njohur për lidhjet e shumta dhe për tipin e paqëndrueshëm që ka. Përfundimi i kësaj lidhje që nuk është pritur mirë nga fansat e artistëve ka ardhur fill pas një raporti tjetër pesë vjeçar që Seldi ka pasur me Dafina Zekën. Përgjatë atyre viteve gjithçka ka shkuar mirë, kur një ditë befas u mësuara se ata nuk ishin më bashkë. Rikujtojmë se Seldi ka qenë dhe

Vjet në tetor Seldi dhe Mimoza kurorëzuan lidhjen e tyre me fejesë, ceremoni e cila qe mjaft private dhe u organizuar në Zvicër vetëm me familjarët e çiftit. Kështu Seldi u pranua si dhëndër në familjen Shkodra. Miqtë e dy artistëve pohuan se meqë lidhja u bë zyrtare shumë shpejt do finalizohet me dasmë në Tiranë.

pjesë e spektaklit "Big Brother". Edhe brenda shtëpisë ai pati një lidhje me Domenikën që bëri mjaft bujë atëherë, por nuk zgjati. Kjo e fundit u komentua asokohe dhe si strategji loje nga ana e tij. Seldi njihet si një nga këngëtarët më të dashur nga publiku kjo për faktin e bashkëpunimeve të suksesshme që ka pasur me Sinan Hoxhën dhe me artistë të tjerë shqiptar. Kjo verë për të ka qenë mjaft impenjative pasi ka pasur koncerte të ndryshme jashtë. Ne urojmë që shumë shpejt Seldi të gjejë lumturinë duke lënë pas krahëve lidhjet që tanimë kanë përfunduar.


Egla Xhemali

Për një kohë të gjatë ata ishin çifti më si maptik i show bizzit shqiptar. Seldi Qalliut dhe Mimoza Shkodra dukeshin tejet të lumtur krahas njëri-tjetrit, por tanimë lidhja e tyre ka marrë fund. Çfarë ka ndodhur mes çiftin? Të dy kanë fshirë të gjitha fotografitë e përbashkëta në rrjetet sociale, duke dhënë shenja se marrëdhënia e tyre nuk është në drejtimin e duhur. Gjithçka ndodhi krejt papritur ashtu siç qenë dhe fillesat e historisë së tyre. Vjet në tetor Seldi dhe Mimoza kurorëzuan lidhjen e tyre me fejesë, ceremoni e cila qe mjaft private dhe u organizuar në Zvicër vetëm me familjarët e çiftit. Kështu Seldi u pranua si dhëndër në familjen Shkodra. Miqtë e dy artistëve pohuan se meqë lidhja u bë zyrtare shumë shpejt do finalizohet me dasmë në Tiranë. Po si lindi historia e tyre e dashurisë? Raporti i artistëve u bë publik dy vite pas ndarjes së këngëtarit nga e fejuara e parë, që jeton në Suedi, Dafina Zeka. Ata patën një bashkëpunim pesë vite më parë për duetin "Pare, pare" nga ku lindi dhe miqësia si kolegë. Në atë kohë, këngëtarit dhe ish-lojtari i "Big Brother", Seldi, ishte i fejuar me vajzën e gazetarit të njohur, Milaim Zeka, fejesë që zgjati pesë

vite. Ajo ishte marrëdhënie në distancë, pasi Dafina jetonte në Suedi, por u tha se koncertet e përbashkëta me Mimozën, bën që ai të afrohej shumë me të dhe të distancohej nga Dafina. Nuk dihej saktë nëse dashuri e re ndikoj në ftohjen e marrëdhënies me ish-të fejuarën, por që nga viti 2012 kur ata realizuan klipin "Pare, pare" u panë gjithmonë në shoqërinë e njëri-tjetrit, për shkak se ftesat për koncertet në Europë i merrnin çift. Mimoza ka arritur ta



Nuk dihej saktë nëse dashuri e re ndikoj në ftohjen e marrëdhënies me ish-të fejuarën, por që nga viti 2012 kur ata realizuan klipin "Pare, pare" u panë gjithmonë në shoqërinë e njëri-tjetrit, për shkak se ftesat për koncertet në Europë i merrnin çift.



BEATRIX RAMOSAJ NË NJË LIDHJE? REAGON KËNGËTARJA

Beatrix Ramosajn nuk e kemi në krah të ndonjë të dashuri dhe së fundi lindën dyshime se ka filluar një romancë. Gjatë këtyre ditëve në media kanë qarkulluar lajme se këngëtarja jonë është në lidhje me reperin e njohur me emrin Escobars. Bukuroshja ka reaguuar përmes një mesazhi të shkurt në llogarinë personale në "Instagram" duke thënë se është "single". "Duke ndryshuar statusin tim nga beqare në beqare", ka shkruar artistja duke e shoqëruar mesazhin me një "emoji" duke buzëqeshur. Më vonë ka reaguuar edhe reperi në fjalë duke thënë se kurrë nuk ka qenë më beqar në jetë dhe "Ju lutem, ndaluni me këto shkrime". Beatrixi është duke punuar me projekte të reja muzikore që do t'i sjellë gjatë muajve në vijim.



TAYNA ME PUSHIME, JA MESAZHI QË KA PËR PUBLIKUN

Tayna është duke i shijuar pushimet verore pas një verë të ngarkuar me mbremje të shumta muzikore. Reperja në profilin e saj në 'Instagram', ka publikuar fotografi të tjera, në të cilat ka pozuar me bikini. "Jam në pushime... Përgatituni të bombardoheni nga shumë fotografi", ka shkruar në përshkrimin e njëres prej fotografive. Theksojmë që vera e këtij viti ka qenë plot me angazhime për këngëtareshen Tayna, e cila hyri fuqishëm në skenën e muzikës shqipe, ndërsa pas koncerteve të shumta, reperja ka gjetur kohë për t'u relaksuar paksa. Tayna depërtoi fuqishëm në skenë më hitin e saj, "Columbiana", që e realizoi në bashkëpunim me Don Phenom në qershor të këtij viti. Këngëtarja vazhdoi të pëlqehet akoma më shumë pas lançimit të këngës "Shqipe", ndërsa javë më parë e ka publikuar projektin e ri, "Fake".



ZBULOHEK ARSYEJA PSE NUK FLASIN LEDIONI DHE ARBANA


Ka kohë që përfillet për një thyerje të raportit mes Ledion Liços dhe Arbana Osmani. Dhe kjo u vërtetua në dasmën e prezantuesit. Arbana Osmani nuk shkoi në Como të Italisë për këtë arsye mediat kanë nisur të ngrenë pikëpyetje se prishja e marrëdhënies mes tyre ka të bëjë me punën në televizion. Mendohet se arsyeja e prishjes së miqësisë është fakti që si producent i 'Big Brother VIP', Ledioni me stafin i kanë besuar prezantimin Luanës, e jo Arbanës si prezantuese historike. Sidoqoftë, mbetet të shihet se sa i vërtetë qëndron një spekulim i tillë. Duhet theksuar se Arbana e ka zbehur interesimin për 'Big Brother', duke u fokusuar tek programet më familjare si 'Dua të të bëj të lumtur', që në sezonin e dytë pati një sukses të jashtëzakonshëm.



LUANA VJOLLCA MERR DHURATËN MË EMOCIONUESE NGA FANSJA

Luana Vjollca është një nga moderatorët që numëron më shumë ndjekës në rrjetet sociale. Së fundmi, një nga fanset e saj më të zjarrta i ka bërë dhuratë një unazë me gur të çmuar dhe një letër. "Sot nuk është ditëlindja jote, por dua të të uroj e para. Festofsh edhe plot të tjera, drita ime, lumturia ime. Dashuria, shëndeti dhe sukcesi qofshin gjithmonë me ty. Shpresoj të të pëlqejë dhurata ime e vogël," shkruhej në letër. "Arsyeja pse nuk ndalem. Sonte me këtë lodhje, kjo ishte gjithçka që kisha nevojë për të vazhduar",- vazhdon më tej Luana duke treguar që mbështetja e fansave të saj i jep forcë për të ecur para.





Humbja e kilogramëve nuk është aspak punë e lehtë, ndërsa interneti është i mbushur me lloje të ndryshme të këshillave dhe "këshilla" se si ta fitoni këtë luftë, që për shumë njerëz është luftë e përhershme.

Dhe derisa shumica e udhëzimeve për t'u dobësuar kryesisht janë shumë të ngjashme (me fare pak dallime të natyrës kozmetike), ekzistojnë ekspertë për dietë nga këshillat e të cilëve do t'u cohen flokët përpjetë, por shumë shpejt do të kuptoni që jo gjithçka që ata pohojnë është aq e çmendur.

Ju sjellim në vazhdim këshilla interesante e të pazakonta për dobësim.

PINI VAJ

Taktika të çuditshme për dobësim që vërtet funksionojnë



Kur shpikësi i dietës së popullarizuar Shangri-La, Seth Roberts, përndryshe profesor i psikologjisë, ka krijuar konceptin e vet, i cili silllet rreth të ashtuquajturave "kalori të pashijshme", të gjithë kanë menduar që është i çmendur.

Kjo dietë pohon se si mund të humbni peshë duke konsumuar 1-3 lugë ujë të

sheqerosur dhe 1-2 lugë vaj ekstra-vgirgjin ulliri në mes vakteve.

Roberts pohon se si ushqimi i llojllojshëm i pasur me shije (siç e konsumojmë kryesisht) në trurin tonë stimulon ndjenjën e urisë, për ç'arsye hamë më shumë dhe grumbullojmë kilogramë. Kur konsumojmë ushqim pa shije ose me

shije të panjohur, truri mendon që jemi të uritur (pse pra do të hanim ushqim pa shije?), për ç'arsye fillojmë në mënyrë më efektive të tretim ushqimin dhe të humbim kilogramët.

HANI EMBËLSIRA GJATË GATIMIT

Nëse jeni një nga kuzhinierët,

të cilët thjesht shijojnë të provuarit dhe të ngrënit e ushqimi që e zieni, ka shumë shanse që do ta prishni oreksin para se

do t'ua prishë oreksin.

VËNIA E KAPËSES NË HUNDË

Të gjithë e dinë që aroma luan rol të rëndësishëm kur është fjala për shije të ushqimit. Nëse nuk na besoni, mbylleni hundën me një kapëse dhe hani një copë qepë dhe një copë mollë - do të vëreni që kanë shije tërësisht të njëjtë. Sido që të jetë, edhe pse tingëllon pak ekstreme (në mos asgjë tjetër, do t'ju shikojnë çuditshëm), vënia e kapëses në hundë do t'ju ndihmojë që të hani më pak.

TORTË PËR KAFJALL

Ngrënia e tortës në mëngjes në fillim duket si këshilla më e keqe për ushqim në histori, por hulumtuesit izraelitë kanë zbuluar që kafjalli me përqindje të lartë të proteinave dhe karbohidrateve, i cili përfundon me desert, ndihmon rregullimin më të mirë të urisë gjatë pjesës tjetër të ditës dhe në fund rregullimin më të mirë të kilogramëve.



Ilir Meta i ngjitet Jezercës: Kjo majë është e bukura e qiellit

Presidenti Ilir Metra ishte dje në Malin e Jezercës, rreth 3 mijë metra mbi nivelin e detit. "Ju përshëndes nga E Bukura e Qiellit nga Maja e Jezercës 2696 m mbi nivelin e detit. Pas një ngjitje malore prej 17 km nga lugina e Valbonës arritëm te kryemaja e Alpeve tona, maja e Jezercës atje ku ke çdo majë në pëllëmbë të dorës e sidomos 3 luginat me përrallorë të Valbonës, Gucisë e Thethit. Nuk ka regjisor, kameraman e fotograf që mund ta pasqyrojë të plotë e reale këtë mrekulli. Sepse maja e Jezercës është E Bukura e Qiellit", deklaroi presidenti i Republikës, Ilir Meta.



Rama godet sërish me veshjen, kravatë me Homer Simpson që vrapon lakuriq



Kryeministri Edi Rama zgjedh të veshë një nga kravatat më të çuditshme deri më tani. Rama njihet për numrin e madh të kravatave shumëngjyrëshe, por kjo që ka zgjedhur këtë herë është e veçantë nga të tëra. Kravata ka të stampuar personazhin e filmave vizatimorë Homer Simpson, në një pozë duke vrapuar lakuriq.

BULEVARDI

POLITIK

Nga merrni seriozitet! 🤪

Presidenti Trump në daljet publike shoqërohet nga sozia e Melanie?



Është Melania Trump apo sozia e saj? Teoria e konspiracionit është rikthyer sërish në vëmendje pas publikimit të një videoje të re të realizuar me 24 gusht në Columbus të Ohajos. Ka pasur në vijimësi aludime në rrjetet sociale se presidenti Trump në mjaft dalje të tij publike shoqërohej nga sozia e Melanie. Pas analizimit të fotografive dhe videove, disa përdorues pretendojnë se kanë gjetur "mospërputhje" dhe "detaje" që tregojnë se si gruaja që shoqëron Donald Trump, në disa raste nuk është Zonja e Parë e vërtetë por sozia e saj që aktron.

Mesazhi i Tahirit: Kanë rënë çatitë, por mbahen themelet

Ish-ministri Brendshëm, Saimir Tahiri është duke shijuar pushimet në vendlindje dhe këtë e thotë me krenari në çdo foto që publikon. Gjatë ditës së djeshme, ish-ministri ka prezantuar me anë të një fotoje dhe rrapin e familjes së tij duke lëshuar një mesazh paksa me 'thumb'. "Rrapi i Tahirajve, - Gusmar; Si në ekran vendlindja më shjellet/ kanë rënë çatitë/ po mbahen themelet" (V.Hodaj) - shkruan në foto Tahiri.



STUDIMET

Veçantia e arkitekturës popullore shqiptare

Akad. Emin Riza

Studimet në fushën e albanologjisë, apo studimet shqiptare, lidhen me veprimtarinë e kombit iliro-shqiptar në hapësirë dhe kohë. Kategoria ndërtimore, e ngritur përgjithësisht prej shqiptarëve për shqiptarët, përfshin një hapësirë të gjerë llojshmërisht, të cilat vijnë në shtim dhe rritje cilësore në kohë, si shfaqje e prekshme e zhvillimit të kombit tonë, vërtetësisht autokton. Kategoritë ndërtimore, sipas funksionit të tyre ndahen në katër njësi: ndërtimet mbrojtëse, ato fetare, shoqërore dhe të banesës popullore. Kuptueshëm dukuria banesë popullore, është ajo paralela e pandashme me jetën njerëzore dhe si e tillë shpërfaqëseja më e vërtetësisht e mënyrës së jetesës në hapësirë dhe kohë. Studimet shqiptare në trojet e Shqipërisë politike dhe përfillshëm dhe në ato të Kosovës, në fushën e banesës popullore shfaqen së pari si veprimtari e studiuesit Emin Riza, ndërkohe që duhet përmendur vepra e hershme dhe me vlera të rëndësishme e studiuesit Pirro Thomo "Arkitektura fshatare e Shqipërisë veriore" (1981). Kolegu Ali Muka ka botuar katër monografi. Emin Riza ka trajtuar që prej vitit 1962, pra deri me sot, 56 vjet pa ndërprerje, banesën qytetare shqiptare kryesisht në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe banesën fshatare të krahinës së Labërisë. Në fushën e botimeve ai është autor, dhe në shtatë prej tyre bashkautor, i 21 veprave për arkitekturën e banesës popullore shqiptare, kryesisht të hapësirave shtetërore të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës. Kjo veprimtari, pjesë e asaj vlerësuese, pra gjurmuese, përzgjedhëse, dokumentuese, vëne në mbrojtje, studimore dhe botuese, e bën atë prekshëm pjesë të rëndësishme të historisë së kombit. Ashtu si përgjithësisht, veprimtaritë në fushën e dukurive shoqërore, edhe fusha e vlerësimit të banesës popullore shqiptare është rrugë e gjatë deri në pambarim, për t'iu afruar përherë dhe më pranë të vërtetave absolute.

Termi banesë, tashmë i konsoliduar, ka pasur parësor atë "të bana", krahas shtëpi dhe emërtimeve të cilat vënë në pah tipare dytësore si: shtëpizë, përdheçkë, me çardak, krevet etj. Banesa, është një term disi përgjithësues, sepse ai është tregues i mbarë hapësirës që rrethohet prej mureve kufizues të banesës dhe oborrit, i cili e rrethon plotësisht, ose pjesërisht atë, duke pasur shpesh edhe ndërtimë ndihmëse, për strehim të kafshëve të ngarkesës, ato ekonomike dhe rrallë të shtëpisë së miqve.

Banesat popullore shqiptare të së kaluarës, duke qenë me njohje të përafërt me ato të lashtat, të shek. XVIII-XIX, tipologjikisht më të hershme, ishin dhe mbeten treguesi i prekshëm i mënyrës së jetesës. Ngritja e banesave, të shumicës së popullsisë shqiptare të së kaluarës, ishte treguesi thelbësor



Banesa shqiptare ndeshen në Kroaci, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Greqi

i bashkësisë sa të hershme, aq edhe të qëndrueshme të familjes, që prej asaj njëkurorëshe deri të ajo shumëkurorëshe, apo patriarkale.

Me përjashtime gjithnjë në zvogëlim të ngritjes se banesave njëfamiljare, prej vetë banorëve të kasolleve, banesat ngriheshin prej profesionistësh. Kuptueshëm tipologjia tradicionale dhe ajo bashkëkohorja, ishin treguesit kryesorë për përzgjedhjen e banesës për t'iu ndërtuar. Kompozimi i banesës, së bashku me teknikën dhe materialet ndërtimore, diskutohej dhe bashkëvendosej prej kreut të familjes dhe kryemjeshtrit të grupit ndërtimor. Banesat njëfamiljare dhe më shumë kurora mbizotërojnë në Shqipëri dhe Kosovë deri në dhjetëvjeçarët e parë të pas Luftës II Botërore. Për arsye zhvillimore të shoqërisë shqiptare, kryesisht me sigurimin e jetës prej veprimtarish jashtëbanesore, parësisht zejtarisë dhe shitjes së

prodhimeve përkatëse, banesa po kthehej përherë dhe me dukshëm në hapësirë qëndrimi të gjinisë femërore dhe vocërrakëve.

Historia, si fushë studimore e bashkësisë njerëzore, përfshin natyrshëm edhe atë të banesës, si bashkëpërbërëse thelbësore në veprimtarinë shumëplanëshe jetësore. Kuptueshëm studimi i banesës popullore në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti, janë krahasimist të vona kohësisht, kryesisht të pas Luftës II Botërore.

Studimet sistematike shqiptare për banesën popullore, i kanë filletrat rreth viteve '60 të shekullit të kaluar. Në treshen e përmendur të studiuesve të veprimtarisë ndërtimore shqiptare, unë u ngarkova me fushën e banesës popullore. Sot,

pas 56 vjetësh veprimtarie, pa ndërprerje në këtë fushë, për arsye dilentante, shpërfillur, madje edhe në vende të zhvilluara, mund të pohoj bindshëm se tashmë në punë dhe nëpërmjet saj, kam arritur të formësoj kriteret studimore në këtë fushë sa të re, aq edhe të rëndësishme të veprimtarisë njerëzore, pra dhe të historisë së kësaj bashkësie. Në dallim prej shkencave ekzakte, studimet albanologjike, që prej nisjes së tyre, shfaqen vijueshëm deri në pambarim, me përpjekje dhe arritje për t'iu afruar të vërtetave.

Siç e ka përcaktuar saktë dhe ngjeshurazi prof. E. Çabej: "Trojet shqiptare janë troje restriksioni". Është fjala për trojet shqiptare, pra të banuara historikisht dhe ende sot prej shqiptarëve, të cilat nuk përfshihen të gjitha në shtetet shqiptare. Më konkretisht, prej verit në jug, banesa shqiptare ndeshen në Kroaci, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Greqi. Shkaqet historike të kësaj tkurrjeje të dhunshme, paraprirë prej mashtrimeve greko-sllave, i kanë detyruar vijimisht shqiptarët e brezave pararendës, vetëm në luftëra mbrojtëse. Qëndrimet shqiptare mund të cilësohen të autoktonisë mirëdashëse, si ndaj 'fqinjëve të hershëm, ashtu dhe të ardhurave prej pyjeve të Rusisë në shek. VI. Madje këta të fundit, për çudi, gjetën djepin e Serbisë, Kosovën, të zënë prej shqiptarëve?! Besojmë se edhe pseudopatriotizmi i skajmë i sllavëve veriorë, dallohet ndaj patriotizmit racional të shqiptarëve, gjithherë autokton, pra pa probleme me dheun e tyre të gjithëhershëm.

Studimet shqiptare të banesës popullore, kryesisht me shembuj të shek. XIX-XX, të cilët tipologjikisht janë të hershëm, krijuan dhe

metodologjinë e bashkëpërputhshme, e cila shfaq kompozimin vëllimor të banesës, si kriterin thelbësor për klasifikimin tiparësor të banesës popullore. Ky kriter bazik, u shoqërua me shpërfaqjen e dukurive të tjera të rëndësishme të ndërtimit-banesë, ato të elementëve kompozicionale, arkitekturore dhe teknike, krahas materialeve ndërtimore. Rrafshi krahasues i mbarë dukurive të mësipërme në hapësirën shqiptare dhe më gjerë në atë Ballkanike, është pjesë e përfillshme e kriterëve studimore, me synimin për t'iu afruar të vërtetave.

Bashkësia e veprimtarive thelbësore gjurmim, përzgjedhje dhe studim i kategorisë ndërtimore banese popullore, ripërsërisim është një proces pambarim, duke qenë gjurmimi dhe përzgjedhja ai kryesor. Në dallim prej kategorive ndërtimore, ndërtimë mbrojtëse, fetare dhe shoqërore, të palidhura ngushtas me jetën, kryesisht në rrafshin familjar, banesa popullore është thelbësisht e lidhur me shkallën e zhvillimit jetësor. Edhe për arsyet e rritjes të pjesëtarëve të familjeve, shumimit të familjeve njërënjëshe etj., kërkesat për ndryshime, ndaj banesave në përgjithësi dhe atyre konkretë, janë përherë në rritje. Kuptueshëm, këto kërkesa, me realizim e tyre cenojnë vlerat autentike të veprës, që lidhen me një përiudhë dhe shkallë të veçantë të mënyrës së jetesës. Në këto rrethana, përshejtimi i veprimtarisë për gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të banesave popullore me vlera përfaqësuese në bashkësinë e kësaj gjinde ndërtimore, kanë përparësi urdhëruese në hapësirë dhe në kohë. Veçanërisht rasti shqiptar në Ballkan, shfaq si një dukuri urdhëruese identifikim e banesës shqiptare në hapësirat shqiptare, në kuptimin e lartpërmendur. Këto banesa, përveç arsyeve të natyrshme për t'iu dëmtuar deri në shkatërrim, janë jashtë përkujdesjeve të duhura, për arsye të kuptueshme.

Prej njohjes sonë të përkujdesjeve për monumentet e kulturës në Shqipëri, do të theksojmë thellësisht të shtetësuar, rikonfirmimin e nevojës urdhëruese për rringritjen e përkujdesjeve profesionalo-administrative për monumentet e kulturës, të arritura para vitit 1990. Lidhur për sa më sipër, gjithashtu, po ripërsëris vlerësimin e Xhevat Erderit, ish-drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Restaurimin e Monumenteve, me seli në Romë, i cili në vitin 1980, pas vizitës në IMK dhe në Berat. Më tha: "Qendra Ndërkombëtare e Mbrojtjes dhe Restaurimit të Monumenteve nuk duhet të jetë në Romë, por në Tiranë". Kalofshim prej pohimeve në veprime, për vlerat e papërsëritshme — monumentet.



Emin Riza

POETI

“Fatos Arapi, poeti që e lamë në harresë”

Fatmira Nikolli

Prej vitesh nuk del nga shtëpia e tij. Miqtë e përmallur më kot presin ta shohin. Sigurisht ai është miku më i madh i poetëve. “Por refuzon ta kapërcëjë pragun e portës”. Poeti Izet Duraku kujton se si jeton sot Fatos Arapi. Shkruan se “gazetat, radiot, televizionet nuk kujtohen as në përvjetorët e tij”, por harron se për të, kolegët nuk flasin, ai vetë jo e jo dhe nuk mbetet shumë për t’u bërë si përkujtim. Shënon se “politikantët deri tani kanë respektuar shkrimtarët vetëm ditën e vdekjes së tyre për me marrë të mbramben pikël drite prej tyre”. Mesazhi që jep Duraku është njerëzor. “Ndoshta poeti Fatos Arapi po bën grevën më të gjatë në historinë shqiptare të letrave duke protestuar me hesh-tjen e vet kundër antivlerave, jovelrave, pseudovlerave letrare dhe të krejt jetës sonë të rrejshme.

Miq të mi të letrave, ju që nuk e harroni kurrë Fatosin! Do të bashkohem gjithmonë me ju për me ngrit zërin në mbështetje të Fatos Arapit. Duhet respektuar Hesh-tja e tij e shenjtë duke e bërë sa më të zëshme hesh-tjen për me ia shurdhuhë veshët shurdhnisë”. vëren Duraku për Arapin.

Fatos Arapi lindi më 1930 në Zvërnec të Vlorës, ndoqi studimet për ekonomi në Sofje, mandej punoi në Tiranë në fillim si gazetar dhe më vonë për një kohë të gjatë si pedagog. Fatos Arapi, bashkë me Ismail Kadarenë dhe Dritëro Agollin, bën pjesë në ata poetë që sollën një kthesë të rëndësishme në poezinë shqiptare të viteve 60. Arapi solli në këtë poezi elemente të modernizmit, madje të hermetizmit. Ai u orientua nga poezia filozofike. Veçanërisht origjinale janë dy përmbledhet e tij të para poetike “Shtigje poetike” (1962), “Poema dhe vjersha” (1966), “Ritme të hekurta” (1968) është më konformiste. Më 1971 i botohet në Prishtinë vëllimi “Kaltërsira”. Vëllimin “Më jepni një emër” ia ndaloi diktatura. Pasojnë vëllimet: “Drejt qindra shekujsh shkojmë” (1977), “Fatet” (i botuar në Prishtinë më 1979), “Duke dalë prej ëndrrës” (1989). Pas rënies së diktaturës botoi vëllimet: “Ku shkoni ju statuja”, T. 1990, “Dafina nën shi”, T. 1991, “Ne, pikëllimi i dritave”, T. 1993, “Unë vdiqa në brigjet e Jonit”, Shkup, 1993, “Më vjen keq për jagon”, T. 1994, In tenebris, T. 1996. Fatos Arapi është një poet që parapëlqen temat ekzistenciale dhe një nga poetët e rrallë shqiptarë që trajtojnë në poezinë e tyre temën e detit. Ka shkruar edhe romanet “Dhjetor i shqetësuar” (1970), “Dikush më buzëqeshte” (1972, ribotuar në Prishtinë më 1973), “Shokët”, 1974, “Deti në mes”, 1986 dhe novelat “Patat e egra” (1970) dhe “Cipa e dëborës”. Ka shkruar edhe vëllime me kritikë letrare

Në një intervistë të dhënë vite

Izet Duraku: Ai refuzon ta kapërcëjë pragun e portës, po bën grevën më të gjatë

më parë gazetares Vera Pelaj, ai thoshte: “Dëgjoj shumë andej e këndej pesimistë që flasin rreth letërsisë në përgjithësi dhe rreth poezisë. Por unë nuk jam pesimist. Unë mendoj se letërsia ecën. Po krijohen emra, po vijnë gjenerata të tjera dhe poezia nuk do të mбет në mes të rrugës. Përkundrazi, me traditën që është krijuar tanimë dhe me tendencat e shumëllojshme të larmishme që janë krijuar me një teknologji krejt të re, poezia do t, shkoj, p, rpara. Pastaj, fakti është që në përgjithësi letërsia shqiptare tashmë e ka të qartë synimin e saj drejt lirisë së njeriut, drejt të drejtave njerëzore të njeriut, në përgjithësi, sigurisht të kombit shqiptar dhe të njeriut shqiptar; në veçanti, mendoj se kjo letërsi është në rrugë të drejtë. Nuk duhet të jemi pesimistë. Unë jam optimist. Natyrisht në moshën time dhe me sëmundjen që kam, nuk mund t’i ndjek të gjithë, por jam optimist dhe ata ecin, ecin...”.

Ai shtonte se letërsia ka ligjet e veta dhe me një moment të caktuar, atje ku ti nuk e pret, del një

talent, i cili bën sintezën, bën përgjithësimin e një plejade të tërë, e cila ka punuar. “Shembulli më i miri vitet ‘35. Nuk ka qenë vetëm Lasgush Poradeci, po në vitet ‘35 këtu ka pasur një gjeneratë të tërë shkrimtarësh. Ka qenë Ali Asllani, ka qenë Asdreni, Fish-ta, pastaj të rinjtë Petro Marko, Nexhat Hakiu, kanë qenë plot, mirëpo në një moment të caktuar, poezia bën sintezën e vet dhe del një talent i fuqishëm, cili sintetizon të gjitha këto. Kështu p.sh. një sintezë e tillë është edhe poezia e Lasgush Poradecit, e cila nuk mund të themi se përfaqëson të gjithë atë gamë të madhe të poezisë shqiptare, që ekzistonte atëherë. Natyrisht Fishta ishte një Fishtë, Ali Asllani ishte një Ali Asllan, Asdreni që një Asdren, Lasgushi një Lasgush, por si doqoftë krijoheshin sintezat, kështu që nuk duhet të jemi pesimistë në këto gjëra dhe nuk duhet t’i kërkojmë në letërsi përnjehersh gjërat. Ato sinteza janë sinteza historike, historia i bën ato zhvillime”, -shprehej Arapi vite më parë.



Prezantohen aplikacionet për gjetjen e të zhdukurve

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Institutin e ish-të Përndjekurve Politikë prezantoi dy aplikacione online, të cilat do të ndihmojnë procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri.

Aktiviteti u zhvillua Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, në mjediset e Autoritetit pranë Gardës së Republikës, në prani të familjarëve të të zhdukurve, shoqatave për të drejtat e njeriut.

Aplikacionet online që u prezantuan nga institucionet dhe organizmat që po punojnë në këtë fushë, do të ndihmojnë në procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri. Ata do të jenë të ndërlydhura me faqen e AIDSSH dhe të IIPP dhe janë në dispozicion të publikut në gjuhën shqipe.

Për të pranishmit folën



znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit dhe Matthew Holliday, drejtor i Projektit të ICMP për Ballkanin, i cili prezantoi Qendrën e Kërkimit Online të ICMP dhe treguesin e vendvarrimeve, si dy mundësi për të ndihmuar familjarët e personave të zhdukur të raportojnë rastet dhe të marrin informacion në lidhje me statusin e rasteve individuale të personave të zhdukur. Familjarët të të zhdukurve bënë prezente rastet e tyre.

Qendra e Kërkimit Online e ICMP-së (OIC) është një mjet për të siguruar informacion për një person të zhdukur. Ky burim online mund të përdoret nga familjet e të zhdukurve dhe të tjerët.

Zhvilluar mbi bazën e përvojën afatgjatë të ICMP për të ndihmuar qeveritë, familjet e të zhdukurve dhe të tjerët, OIC është një vend ku informacioni konkret dhe i përdorshëm mblidhet e ruhet në mënyrë që të mund të përdoret kur

është e nevojshme në kërkimin e personave të zhdukur. Aplikacioni mundëson paraqitjen e rasteve të personave të zhdukur duke dhënë detaje, si emrin, datën e lindjes, vendin ku personi i zhdukur është parë së fundmi.

Nëse ka informacion shtesë për një person të zhdukur, mund të paraqitet edhe ai. Aplikacioni mundëson edhe marrjen e informacioneve nga familjet e personave të zhdukur që kanë dorëzuar kampanjën e ADN-së tek ICMP, për të përcjellë statusin e rastit në secilin fazë të përpunimit.

Treguesi i vendvarrimeve është aplikacion lehtësisht i përdorshëm dhe lejon raportimin e varreve masive dhe vendeve të tjera ku mund të gjenden mbetje njerëzore të personave të zhdukur. Informacioni mund të jepet në mënyrë anonime ose jo, duke u mundësuar përdoruesve që të japin informacion mbi vendndodhjen e varreve klandestine. Të gjitha informacionet e dhëna janë konfidenciale dhe ruhen në bazën e të dhënave për t’u përdorur në procesin e gjetjes dhe identifikimit.

Më 18 korrik 2018, ICMP nënshkroi një marrëveshje me qeverinë shqiptare për ta vënë në baza institucionale punën për kërkimin dhe gjetjen e të zhdukurve. AIDSSH dhe IIPP janë të angazhuar në këtë proces.

Po më tej, çdo të ndodhë?

Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... Me këtë rast, duke u ndalur në pasojat tragjike vijuese, ekspertë dhe analistë me emër evidentojnë ndër shkaqet kryesore dështimin e fuqive fituese për t'i dhënë përgjigjen e duhur pyetjeve madhore "What comes after" ose, "Po më tej, çfarë do të ndodhë?"

Historia e këtyre 100 vjetëve dëshmon se ndonëse jo e thjeshtë në praktikë, injorimi i kësaj pyetjeje strategjike, një përgjigje subjektive "për të larë gojën" ose sa për të kënaqur interesat politike të castit është e mbarësuar me pasojë të parashikueshme sidomos në fushën e politikës së jashtme, paqes dhe sigurisë.

Dihet se vendimmarrja strategjike është rezultante e analizës së aktorëve dhe faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm politikë, ekonomikë, socialë, të sigurisë, etj. Megjithatë, sado e drejtë të jetë kauza dhe sado e përkryer analiza përkatëse, sërish ajo përbën vetëm gjysmën e punës. Sepse, që ky vendim të çojë në realizimin e objektivave të synuar, kërkohet doemos të parashikohet paraprakisht, me variantin maksimal, por dhe atë minimal se çfarë do të ndodhë më tej; me një fjalë, punët do të shkojnë punët më mirë apo më keq, bilanci do të jetë pozitiv apo negativ?

Traktati i Paqes i nënshkruar në Versajë nga fuqitë e mëdha fituese pas mbarimit të Luftës së I Botërore nuk i dha përgjigjen e duhur kësaj çështjeje madhore; ai vendosi masa dhe sanksione dragoniane, të cilat ishin praktikisht të papërballueshme nga Gjermania. Versaja futi "në një thes" forcat demokratike të përfaqësuar nga Republika e re e Vajmarit me grupimet antidemokratike nacionaliste dhe ekstremiste në Gjermani. Këto të fundit kontribuan ngjyten me shpejtësi të dhunshme në pushtet të Hitlerit që çoi në Luftën e II Botërore.

E kundërta ndodhi pas mbarimit të asaj lufte; SHBA dhe aleatët fitues në Europë patën një përjasje dhe strategji tërësisht të ndryshme dhe të diferencuar Ato nxorën menjëherë para drejtësisë në Gjyqin e famshëm të Nurenbergut fajtorët dhe përgjegjësit e asaj tragjedie; njëkohësisht dhanë përkrahjen dhe mbështetjen e gjithanshme për forcat dhe sistemin e ri demokratik në vendet humbëse, Gjermani, Itali dhe gjëkë, fillimisht me Planin e famshëm të ndihmave "Marshall". Më tej, duke zëvendësuar "të drejtën e forcës" me "forcën e të drejtës" për garantimin e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme, me nismën e SHBA-ve u hodhën themelet e rendit të ri botëror shumëpalësh; u krijua OKB-ja me agjencitë e saj të specializuara si Banka Botërore, FMN etj.

Nga ana tjetër, për të shmangur përdorimin e atomit, qymyrit dhe çelikut si "lëndë e parë" për luftëra



dhe konflikte të përgjakshme, si humbësit dhe fituesit e luftës - Gjermania, Franca, Italia dhe tre vendet më të vogla të Beneluxit themeluan BE që më vonë u kthye në një projekt madhor politik, ekonomik dhe social.

Në vitet 60, nëse regjimi sovjetik dhe ai gjermano-lindor nuk deshë t'ia dinte se çdo të ndodhte pas ndërtimit të Murit më 1961, me të cilin dhe nga pikëpamja e imazhit "në vend që t'i vinte vetullat, i nxori sytë" imazhit të socializmit, e kundërta ndodhi me SHBA-të. Gjermaninë Perëndimore dhe aleatët e tjerë të mëdhenj. Sidomos shtatë vite më vonë, pushtimi i Çekosllovakisë pas "Pranverës së Pragës" i bindi ata se diktaturat lindore nuk mund të rrezoheshin më me luftë dhe me ushtri. Ndaj, një përgjigje të pyetjes "se çdo të ndodhë më tej", Kancelari nobelist Willy Brandt lançoi "Ostpolitikën" ose "ndryshimin nëpërmjet afrimit me Lindjen" deri në shembjen e Murit të Berlinit më 9 Nëntor 1989 që shënoi ribashkimin gjerman dhe atë evropian.

Duke shkruar këto radhë m'u kujtua një takim i gjerë i ish-Kancelarit gjerman Gerhard Schröder në Berlin janar 2003, kur së bashku me homologun francez Shirak iu kundërvu hapur ndërhyrjes ushtarake amerikane kundër Irakut. Isha në sallë si i ngarkuar me punë i ambasades sonë kur Schröderi u shpreh qartë se nuk bëhej fare fjalë për karshillëk ndaj aleatit amerikan, por vetëm se Gjermania kishte një përgjigje krejtërisht ndryshe ndaj pyetjes që ai e tha në anglisht "what comes after". Koha si gjykatësi më i mirë tre-

goi se ndryshe nga sa mendonte ish-Presidenti Bush, ajo ndërhyrje nuk solli demokracinë në ato vende dhe as e çrrënjosi terrorizmin që, në fakt, mori vull dhe më të madh me pasojat tashmë të njohura.

Duke qëndruar në Lindjen e Mesme, 40 vjet pas largimit të detyruar të Shahut të Iranit që "ra nga shiu në breshër" me krijimin e Shtetit Islamik, administrata amerikane bëri tërheqjen e dytë nga ai vend me largimin e njëanshëm nga Marrëveshja 6-palëshme mbi Atomit në vitin 2015. Madje, rivendosja e sanksioneve të ashpra ekonomike nga të cilat preken edhe vendet perëndimore. Nga ana tjetër BE-ja, Rusia dhe Kina si bashkëmbështetëse janë kundër këtij veprimi, sepse siç nënvizoi në një konferencë shtypi kryediplomati gjerman Heiko Maas, ata dallojnë me SHBA pikërisht në përgjigjen ndaj pyetjes "çdo të ndodhë më tej". Më konkretisht, a ka garanci se prodhimi i bombës nga Irani mund të shmanget apo përshpejtohet apo e kundërta mund të ndodhë? A i ndihmon ky akt forcat reformatore apo dashur pa dashur "shpie ujë në mullirin" e konservatorëve fanatikë me pasojë të paparashikueshme?

Vërtet që SHBA si vendi më i fuqishëm me vendosmërinë e tij do të triumfojnë në çdo rast, por a mos ka rrezik që kjo të ishte "fitore si e Pirros"? Po, Marrëveshja me Iranin nuk është e përkryer; por ku ka një të tillë sot në botë! Kryesorja, a nuk ka rrugë të tjera që në konsultime të përbashkëta diplomatike dhe në kuadrin e traktateve ndërkombëtare marrëvesh-

ja ekzistuese të përmirësohej e jo të prishej e të kthehej në një tjetër "mollë shëri" me aleatët evropianë?

Duke u kthyer në Europë, padyshim rasti më spektakular kur në Londër nuk u mendua seriozisht se "çdo të ndodhë më tej" është ai i Referendimit për daljen e Britanisë së Madhe nga BE. Pyetja "Po apo jo", të ikim apo të rrimë" nuk mori fare parasysh raportin tërësor kosto/përfitim për kryesisht ndjenjat nacionaliste dhe fajësimin ndaj Europës, duke hedhur në kosh përfitimet prej saj. Aq e vërtet është kjo sa në përfundim të referendimit si qeveria dhe breksitasit nuk e prisnin të humbitnin apo fitonin dhe të dyja palët u kapën gafil. Madje liderët e Brexit dhanë dorëheqjen, se aq ishte misioni i tyre, tani qameti le të bëhej !!!

Këtë e kuptoi më në fund Kryeministria May, e cila për ndërgjegjësimin e politikës dhe publikut për çfarë mund të ndodhë pas kësaj ka përgatitur një dokument madhor me 80 alternativa lidhur me pasojat e mundshme të "divorcit pa letra" ("no deal" nga BE-ja.

E njëjta situatë paraqitet dhe pas përplasjes politike dhe ekonomike ndërmjet SHBA-ve dhe Turqisë, dy aleatë strategjikë tradicionalë. Shumë analistë dhe ekspertë me emër theksojnë se ash-përsimi i mëtejshëm i këtij konfliktit nuk dihet se çfarë pasojë mund të sjellë, jo vetëm për Turqinë por sidomos aleancën dhe vlerat perëndimore. Mjafton të rikujtojmë se ajo ka ushtrinë e dytë më të madhe në numër pas SHBA-ve në NATO, ajo është korridorit strategjik për në Kaukaz;

Turqia nuk u zgjodh rastësisht si vendkomanda e forcave tokësore të NATO-s për Evropën apo Radari Qëndror i Mbrojtjes Raketore të Europës. Por, sepse është nyja lidhëse me Rusinë dhe Lindjen e Mesme; pa harruar se Turqia ka tre vjet që falë Marrëveshjes me BE-në ka në dorë çelësat e krizës së refugjatëve duke mbajtur mbi 2 milionë të tillë, etj.

Shkurt, Evropa dhe Perëndimi nuk mund të bëjë dot përpara pa Ankarën apo kundra saj. Pa përmendur mundësinë e një aleance të saj me Kinën, Rusinë, etj.

Natyrisht Turqia ka shumë probleme në fushën e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, por ato mund të trajtohen dhe zgjidhen vetëm nëpërmjet dialogut politik, kanaleve diplomatike dhe jo me sanksione, ultimatumet dhe izolim.

Ndaj me të drejtë BE-ja, Gjermania, Franca, etj. pa hequr dorë nga rezervat dhe kritikët e tyre, i kanë shtrirë dorën e bashkëpunimit Turqisë, jo për "inat dhe karshillëk" ndaj SHBA-ve, por për të shmangur variantin më të keq të mëtejshëm.

Së fundi, një ndër shembujt më të freskët kur dhe politikanët e Kosovës i shmangen ose i përgjigjen sipas "humorit apo midesë" së vet politike pyetjes se "çdo të ndodhë më tej" është debati i ndezur nga Presidenti Hashim Thaçi lidhur me korrigjimin e kufirit me Serbinë. Siç kanë pohuar shumica e analistëve vendas dhe të huaj, deklarime të tilla rrezikojnë të hapin "Kutinë e Pandorës" që vështirë të ketë forcë/fuqi që ta mbyllë sërish. Sepse praktikisht ai propozim të kthen 20 apo më shumë vite më pas në histori, por vetëm se tani kushtet, rrethanat, aktorët dhe faktorët politikë dhe pesha e tyre specifike kanë ndryshuar si nata me ditën, kur komuniteti ndërkombëtar, vetë SHBA dhe BE po ndeshen me çështje shumë më të mëprehta.

Por para se të vijmë të "Kutia e Pandorës" ballkanike, a mund të kërkojë diplomacia jonë dhe ajo e Kosovës njohje të reja përpara pikëpyetjes së madhe se çdo të ndodhë më tej me Kosovën? Po disa vende të tjera që e kanë njohur Kosovën, dhe të ndodhurano nën tryninin serbe deri sa të zgjidhet problemi mund ta rishohin pozicionin dhe të tërheqin njohjen e mëparshme?

Të mos harrojmë se 20 vjet më parë, pasi analizuan dhe parashikuan drejt se ç'mund të ndodhte më tej në Ballkan dhe që të mos përsëriteshin më tragjeditë e mëparshme të përgjakshme, SHBA dhe BE zbatuan Strategji tërësore deri te Procesi i sotëm i Berlinit; mirëpo, ato nuk kanë fare të bëjnë me ndryshim/korrigjim kufijsh, ca më pak etnikë, por me paqen dhe integrimin e plotë Euro-Atlantik.

Krahas arritjeve, rastet kur mendohet cektazi ose dhe injorohet përgjigja e duhur ndaj pyetjes "çdo të ndodhë më tej" vazhdojnë të shfaqen edhe në politikën tonë të jashtme, por kjo meriton një shkrim tjetër.

Opinioni *i* Ditës

Mbreti lakuriq

Nga Ilir Kalemaj

(vijon nga faqja 1)

... fund në horizont. Ngjashëm me të përpjetën që kanë marrë refugjatët e gjorë që në përpjekje për të kapur El Doradon europiane, fakti i degdis në këtë yrt të shkretët të Ilirikut me ftesë të pakërkuar të vetë atij, që është, siç do e quanin miqtë tanë amerikanë, "jack of all trades, master of none". I cili edhe në piskun e vapës, shëtit nëpër qendrat e "Rilindjes urbane" me ymamotot veshur, që gojë të liga i quajnë brekushe dhe me aplikacion në dorë u tregon fshatarëve të rreskur videot e rrugëve virtuale të kuruara me gjeometri euklidiane. Ose u bën thirrje aplikuesve të përjetshëm të zyrave të punës të denoncojnë te portali i Shqipërisë që (nuk) duam, çdolloj sjelljeje qafiri të pandrejtshëm që t'ia zbusë kurrizin paq në mbledhjet kolektive pas *dacibaove* që kanë ardhur në vëmendjen e të drejtit.

Herë-herë, i rreptë në kërkesë-llogari, por edhe i gjerë kur fjala bie, pas ndryshimeve të njoftuara muaj më parë, i rikonfirmim kolltukofagët ministra dhe bash niset për resme-n me Ronaldon, me kostum zyrtar kësaj here, jo si ato samitet e mërztishme të BE-së dhe NATO-s ku atletet e lezetojnë dhe i japin ngjyra ndryshe duke kontrastuar me gri-në e përzishme të homologëve që tjerrin veç çështje serioze. Tablate të "Demokracisë së vitrinës" kjo, ku bashkë me sivëllezër *fasadistë* të rajonit kanë ditur me iu shmang me stil detyrimeve kontraktuale të skifterëve europianë.

Akoma më kuller duket për së largu edhe kur mungon ndoca ditë dhe e zëvendëson ekraneve të përnatshme "doppelganger"-i i tij i preferuar, kryebashkiaku trendy kullabërës i Tiranës, delfini mëngëpërvësuar dhe i papërtueshëm për urdhrat porë të shefit të tij të naltë. Dhe kur kthehet me zë dhe bujë deklaron shifra rekord të rritjes së turistëve (paçka se një e treta vijon nga Kosova që ua ngriti gardhin dhe grackën e gjobës bash në Kukës) dhe ulje të krimit (ku këtu ia prish një vrasje haluçinante dhe tonelatat me hashash që vijnë në kapen nga fqinjët italianë), duke premtuar se ai by-passi i Fierit do bëhet pasi të jenë harxhuar këto 770 milionë euro për katër rrugë me PPP (partneritet pirat-plackitës) që janë dhënë deri tani. Mesatarja prej 10 milionë euro km2 nga 1 milionë që ka qenë 10 vjet më parë, pra rritje 10-fish justifikohet me ritmet e zhvillimit që ka vendi.

Ritme të jashtëzakonshme këto paçka se vijojmë çudi, çudi, të jemi të fundit në Europë për të ardhurat për frymë, sidomos kur e matim me fuqinë blerëse, por ndër të parët për korrupsio-



nin më të lartë, të fundit për investimin në kërkimin shkencor dhe inovacionin, por më të përmendurit për krimin e organizuar, të parët në Europë për numër emigrantësh dhe

azilantësh që janë larguar këto 5 vjet, por kompensojmë duke pasur mijëra studentë më pak në shkollat e larta dhe dhjetëra mijëra më pak në sistemin parauniversitar, të parët në Eu-

ropë që shpenzojmë pjesën më të madhe të të ardhurave mujore për ushqim, por të fundit në kontinent për pensionet duke na lënë mbas dhe Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi. Të parët për bashkëjetesën e shkëlqyer fetare dhe mungesën e luftë-nxitjes në një rajon fuçi baruti, por ndër të fundit në rrugën plot pengesa për integrim. Të parët në ngrësoje, por të fundit në menaxhimin e plehrave. Të parët për numër sipërmarrësish individualë dhe të vet-punësuar, por të fundit për sa i përket ndihmës nga shteti, goftë në ndihmë ekonomike, aftësim profesional apo punë-gjetje nga zyrat e mbaruara të punës. Të parët në eksport truri dhe të fundit në drejtim. Paçka se e quajmë drejtimi i duhur!

Herë-herë, i rreptë në kërkesë-llogari, por edhe i gjerë kur fjala bie, pas ndryshimeve të njoftuara muaj më parë, i rikonfirmim kolltukofagët ministra dhe bash niset për resme-n me Ronaldon, me kostum zyrtar kësaj here, jo si ato samitet e mërztishme të BE-së dhe NATO-s ku atletet e lezetojnë dhe i japin ngjyra ndryshe duke kontrastuar me gri-në e përzishme të homologëve që tjerrin veç çështje serioze.

HOROSKOPI

DASHI

Do të shqetësoheni për shkak të disa problemeve shëndetësore. Do t'ju duhet të merrni një vendim për të cilin do t'ju ndihmojë shumë familja. Sot është dita juaj me fat kështu që përpuni fort. Do të largoheni për disa ditë, por mos u shqetësoni, gjërat do të ecin mirë edhe në mungesën tuaj.

DEMI

Do të sakrifikoni lumturinë për hatër të familjes. Mos investoni në sipërmarrje të përbashkëta dhe skema të dyshimita financiare. Disa argumente të panevojshme mund të sjellin tension në familje. Dëgjoni më të mëdhenjtë dhe mendoni me qetësi për të zgjidhur problemet tuaja.

BINJAKET

Shtatzënat e kësaj shenje duhet të bëjnë kujdes për shëndetin. Kushtojini më shumë vëmendje partnerit/partneres suaj, pasi duke shumë të kundërtën do të krijoni tension. Mos u tregoni emocional tekta jeni në një takim biznesi.

GAFORJA

Ka gjasa që të gëzoheni për suksesin e të tjerëve duke i vlerësuar ata. Do të keni dëshirë dhe do të mendoheni rreth ideve për të fituar para në një mënyrë sa më të shpejtë. Mund të përfshihen në një lidhje të re romantike krejt papritur.

LUANI

Bëni kujdes për shëndetin. Ka gjasa të pësoni humbje nëse investoni pa marrë keshillën e duhur. Përgjegjësitë familjare do të rriten edhe më shumë duke iu sjellë tension në familje. Sa i përket anës romantike, nuk do të jetë dita juaj me fat.

VIRGJERESHA

Përfshihuni në disa akte bamirësie, pasi do t'ju bëjë të ndiheni shumë mirë. Disa kontrata të reja mund t'ju duken se do t'ju sjellin fitim, por nuk është ashtu siç e mendoni. Mos ndërmerrni vendime të nxituara sa i përket investimeve dhe mos shpenzoni para për gjëra të kota.

PESHORJA

Duhet të merrni mjekim pasi do të keni rezistencë të dobët. Ka gjasa që gjatë punës të irritoheni dhe të humbisni kontrollin, kështu që bëni mirë të përgatiteni për një situatë të tillë. Nuk është dita e duhur për të udhëtuar.

AKREPI

Përpuni të mos i neglizhoni përgjegjësitë familjare. Do të keni probleme me financat, por miqtë tuaj do t'ju ndihmojnë pamasë duke ju zgjidhur problemet. Dikush mund të futet mes dashurisë suaj. Bëni mirë t'i pranoni gabimet, pasi kjo do të ndikojë në favorin tuaj.

SHIGJETARI

Duhet të bëni të pamundurën për t'u çliuar nga stresi. Meditimi dhe joga janë një ndër mënyrat më të mira për t'i bërë ballë kësaj situatë. Gjatë ditëve në vijim do t'ju shfaqen disa mundësi shumë të mira, kështu që tregohuni të vëmendshëm dhe mos i humbisni shanset.

BRICJAPI

Sot keni nevojë të relaksoheni dhe të gjeni lumturinë mes miqve të ngushtë dhe anëtarëve të familjes. Burime të reja të ardhurave do të gjenorenë mes personave që ju njihni. Sjellja irrituese e partnerit/partneres suaj do t'ju mërzi.

UJORI

Duhet të ndryshoni idetë nëse dëshironi të jeni të suksesshëm. Kjo do të zgjerojë vizionin tuaj, do të përmirësojë personalitetin dhe do t'ju pasurojë mendjen. Mos shpenzoni më shumë seç duhet për artikuj luksozë shtëpie.

PESHQIT

Do të keni shumë përgjegjësi mbi shtëpinë. Duhet të jeni të kthjellët që të ndërmerrni vendimet e duhura. Sa i përket anës romantike, do të pësoni një krisje për shkak të disa diferencave në çft.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET




INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë e pasur me minerale.
- Ascoli në tabela.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.
- Janë felinë të egër.
- Marubi i fotografisë.
- Janë meduza.
- Një anarkist i famshëm.
- Smith filozof.
- Susanna shkrimtare italiane.
- Shkurt për company.
- Organizma Autonome Kombëtare.
- Mbarojnë punime.
- Ndezur në aparaturë.
- Bëjnë në art me re.
- Nduket për gjysmë.
- Mbyllin fushat.
- Luca bomber.
- Emri i parë i Pasolini-t.
- Një mund të jetë fetar.

- Lidhen të parat.
- Fundi i një faze.
- Emri i Bismarck.
- Kant e Diabolik.
- Ze... në traget.
- Ente Informacioni Rajonale.
- Triplet e Trëndafilë me kredi.
- Rruga e Ferenc Molnar.
- Në krye të notarëve.
- Gjysmë tatimi.
- Ushtrihet me cd false.

VERTIKAL

- Numër i shkurtër.
- Britame Arkimedit.
- Inicialet e Paganini-t.
- Fundi i Turandot.
- Është fjetore ushtarësh
- Parker regjisor.
- Kështu quhet që ushqim kundër intoksikimit.
- Një birrë e jona.
- Mund të jenë përirimi.
- Festat pa fat
- Qendër ditore.
- Janë nomadë.
- Fillojnë atletikën.
- Është brinjë në skuadër.
- Sidney i Serpico.
- Qe centauri që mësonte Akilin.
- Në mes të një kanali.
- Bëhet për zakon.
- Tregon martesë.
- Një super... për shopping.
- Vala e stadiumit.
- Fillojnë poshtë.
- Një provë... inteligjence.
- Vaçë e famshme e këngës tonë.
- Fillojnë vallen.
- Para es Salaam.
- Linearë pa larë.
- Nota e diapzonit.
- Mbyllin një shtëpi.
- I keni në dorë.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Është skuadra e donatorëve
- Mbyllin një turp.
- Mund të jetë unik
- Një i absurdit është i Samuel Beckett
- Qyteti i përjetshëm.
- Interpreton Sandokan.
- I ka tek tenda.
- Është këngëtar lirik
- Arturo i Brecht.
- John, i forti i Sylvester Stallone-s.
- Françesku kantautor.
- Është religjion politeist.
- Qerre pa qe.
- Gjysmë alarmi.
- Është shtypi i ZP.

VERTIKAL


- Kush ka... ka zët.
- Altini mesfushor.
- Janë vajzat në atletikë.
- Është shpend lagune.
- Gjysmë thyese.
- Udhëhoqi Argonautët.
- Mund të jenë fotografikë të tillë.
- Fillojnë panikun.
- Janë çnjerëzore.
- Mund të jetë e hollë dhe therëse.
- Edi në krye të PS.
- Është lloj papagalli.
- Fund turni.
- Është dëshmore... çuditërisë.
- Para devils për lojtarët e Manchester United.
- U shkrua nga Kadare
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Pak titanike.
- Arbeni pa çifte.
- I ka tek treni.
- Mund të jenë pushimi
- Mund të prishej nga jë... kleçkë.
- Në krye të bashkisë.
- Është kundërshtar në dashuri
- Meta në krye të LSI.
- I vidhet ustait.
- Jeppet e Artë në Cannes.
- Është pije e jona.
- Kufizojnë kënde.
- Fillojnë lehtë.
- Është dritëshkurtri.
- Është numri i... të parit.
- Fillojnë nazet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			7	5				
	1			6	8			
6							3	9
9	4		1					7
	3		8		5			
				3		1		2
7							2	
			5	9		6		
			2			5		4

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	5	8	1	3	6	4	9	7
1	3	7	4	2	9	6	5	8
6	9	4	8	5	7	2	1	3
4	8	9	5	7	3	1	2	6
3	1	5	2	6	8	7	4	9
7	6	2	9	1	4	3	8	5
5	7	1	3	9	2	8	6	4
8	2	6	7	4	5	9	3	1
9	4	3	6	8	1	5	7	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Dënim i një gënjeshitari nuk është se nuk e besojnë, por se ai nuk mund t'i besojë askujt.
- Njeriu sa më pak ëndërron aq më pak beson.
- Një libër i lexuar nga një mijë njerëz të ndryshëm janë një mijë libra të ndryshëm.
- Lumin do ta njohësh në qoftë se noton, njeriu në qoftë se bisedon.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	8	4	2	4		13	1		13	
18	3	1	4		18		3		17	15	1
8	1	10		10		10	1	3	1	6	8
6		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	18
17	2	4	5	12		2	14		17	5	3
	8	1	7	6		3	1	10	1		
4	5	12			4	6	4	18	7	7	6
1	A	3	R	E	S		1	5		2	3
13	19		1	3		20	5	4	6	10	6
1	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8

T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H	
O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E	
G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T	
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
R	S	L	R	E	T	E	E	R	I	K	
P	E	L	O	T	A	D	V	M	A		
S	O	T	R	T	A	R	E	E	T		
T	R	G	P	A	R	E	T	E			
E	T	L	A	R	I	T	M	I	A		
F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A	
A	D	I	T	E	T	T	O	M			
N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	E	A	R	I	S		
A	L	N	E	N	E	N	A	P	T	O	P	
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
I	A	S	M	O	D	E	U	M	I	R	A	
S	A	M	T	A	R	A	F	E				
M	B	R	O	N	I	N	A	R	I	E	T	
H	A	B	E	R	I	O	M	A	R	A		
R	E	I	T	S	E	R	I	T	E	T		
T	E	M	E	B	E	L	I	V				
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	I	E	P	R	M	I	T	E	
I	N	A	T	U	M	A	D	T	E	S		
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	A		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A	U	
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S			
R	A	A	F	J	O	E	B	E	L	A		
I	T	A	A	A	N	N	A	K	I			
Z	E	K	L	A	N	A	I	S	A	R	N	A
O	E	L	L	I	L	I	M	E	D			
T	E	B	A	R	I	T	O	N	T	O	R	
T	O	K	A	A	L	T	N	L	E	R	A	
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mënçura

- Që të vendosni se çfarë të lexoni, hapni një libër në faqen 69 dhe lexoni. Nëse ju pëlqen kjo faqe, blini librin.
- Asnjë njeri nuk mund ta kuptojë atë që nuk e ka përjetuar.
- Nëse grindesh me një budalla, është mirë që të pyesni veten se mos dhe ai bën të njëjtën gjë.
- Unë ende nuk kam takuar njeri prej të ciit nuk mund të mësoj diçka.

